



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
“Studime Religjioze” me profile “Krahasimi i Religjioneve”,
“Çështje të Sigurisë”**

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë
“ Universiteti European i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr.Zana Strazimiri

2. Dr.Elda Zotaj

Korrik/2021

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit Master i Shkencave në "Studime Religjioze me profile:
Krahasim i Religjioneve; Çështje të Sigurisë" të ofruar nga Unevirsiteti "European i
Tiranës"**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i shkencave "Studime Religjioze", me profile, "Krahasimi i Religjioneve", "Çështje të Sigurisë".
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 688 datë 15.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite/ 4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	8 PAE/ 3 PAK v.a 2018-2019 7 PAE/ 1 PAK v.a 2019-2020
18	Numri i studentëve:	7 studentë v.a 2018-2019 4 studentë v.a 2019-2020 0 studentë v.a 2020-2021
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i ciklit të dytë të studimit Master Shkencor ‘Studime Religjoze’ me profile “Krahasimi i Religjioneve”, “Çështje të Sigurisë” është program i hapur me urdhër MASR nr. 688 datë 15.10.2018 dhe ofrohet nga Departamenti i Shkencave Humane dhe të Komunikimit, njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale të Universitetit Europian i Tiranës.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademik (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master Shkencor” në “Studime Religjoze”, me profile: “Krahasimi i Religjioneve”, “Çështje të Sigurisë”.

Ky program studimi synon të ofroj tek studentët njohuri të thelluara në lëmin e besimeve fetare, veç e veç dhe në bashkëveprimin e tyre fetar, historik, social e kulturor. Ky program synon ta pajisë studentin me dije dhe njohuri komplekse që do ti shërbejnë sa vet institucioneve fetare ashtu dhe institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore por edhe atyre jo qeveritare.

Ky program studimi ofron mundësi studentëve që të fitojnë njohuritë e duhura teorike dhe aftësimin e tyre në fushën e studimeve të religjionit. Programi mbështetet nga një staf pedagogjik i specializuar në këtë fushë, nga personalitete që luajnë një rol të rëndësishëm në jetën fetare të vendit por dhe e eksperiencia në fushën e mësimdhënies.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Raporti është përgatitur nga një grup ekspertësh të vlerësimit, njohur si Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), ngritur nga ASCAL me Urdhër Nr.31, datë 05.05.2021, në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar.

Grupi, në vlerësimin e tij është bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dorëzuar nga UET, dokumentacioni shoqërues i raportit dhe mbi vizitën organizuar pranë këtij institucioni më 26-27 Maj 2021. Po ashtu, Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, dhe udhëzimet e ASCAL-it.

Gjatë vizitës në UET, GVJ ka zhvilluar takime me të gjithë aktorët e UET të përfshirë në këtë proces, nga strukturat drejtuese të fakultetit, anëtarët e departmenti deri tek zyrat menaxheriale dhe horizontale siç janë burimet njerëzore, sekretaria e mësimore, si dhe takime me studentët e programit.

Ecuria e procesit është koordinuar nga Specialisti i ASCAL-it i cili ka asistuar GVJ-në dhe ka koordinuar procesin e mbledhjes së dokumentave shtesë të kërkuara nga GVJ gjatë vizitës në institucion.

Në lidhje me komentimin e IAL-së të ardhur pranë ASCAL me datë 02.07.2021, GVJ e mori në konsideratë dhe e ndryshoi atë në raportin final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Studime Religjose” me profile “Krahasimi i Religjioneve”, “Cështje të Sigurisë”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit “Master i Shkencave në Studime Religjose” ofrohet në shërbim të interesave kombëtare, bazuar në statutin e institucionit, ku paraqitet vizioni për të kontribuar “për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare” dhe misioni për “t’i shërbyer dijes së shoqërisë shqiptare” nëpërmjet realizimit të një “procesi cilësor edukimi” [ref: Statuti UET]
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në planin strategjik për zhvillimin e programit të studimit “Master i Shkencave në Studime Religjose”, përcaktohet si objektivi përgatitja e specialistëve “të nivelit të lartë, ekspertë, të aftë për menaxhimin e çështjeve ndërfaqetare dhe atyre të sigurisë në veçanti, të komunikimit dhe dialogut e marrëdhënieve ndërkulturore e ndërkombëtare në përgjithësi”. Programi zbatohet në rrethanat kur kërkohet të thellohet e konsolidohet më tej tradita e bashkëjetesës fetare në Shqipëri, fryma e mirëkuptimit, bashkëpunimit e tolerancës fetare e dialogut ndërkulturore, ndaj formimi dhe përgatitja e specialistëve dhe studjuesve të çështjeve fetare e të sigurisë u shërben këtyre nevojave aktuale, duke zgjeruar dhe thelluar mundësitë në fushën studimore dhe akademike për qasje ndaj problematikave të mprehta që lidhen drejtpërsëdrejti me ruajtjen e forcimit të vlerave e identitetit tonë kulturor e kombëtar. UET ka krijuar një traditë dhe infrastrukturë përkatëse në fushën e kërkimit e aktiviteteve shkencore, të forumeve të hapura shkencore, të përkthimeve e publikimeve në shërbim të procesit mësimor e forcimit të vlerave akademike e atyre kulturore kombëtare. [ref: Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH në Studime Religjose; Publikimet dhe veprimtaria kërkimore e stafit akademik 2017-2020]

Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Në hartimin e programit të ciklit të dytë të studimit, “Master i Shkencave” në “Studime Religjioze”, synohet t’u jepet studentëve “një edukim cilësor, duke u bazuar jo vetëm te kërkimi shkencor, por edhe tek njohuritë praktike dhe teknike, nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, aftësimit për përdorimin e arritjeve më të mira të shkencës, si dhe forcimit të partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare. Ky program është në përputhje me misionin e fushën e veprimtarisë së UET për të qënë “qendër ekselence në formimin akademik të studentëve..., qendër ekspertize e specializuar në fushën e studimeve shoqërore-politike..., qendër ekselence për kërkimin shkencor”. Fusha e Studimeve Religjioze, si sektor i rëndësishëm i studimeve humaniste, zgjeron e pasuron më tej profilin e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale duke dëshmuar rëndësinë që institucioni i jep zhvillimit të humaniteteve e shkencave sociale. [ref: Statuti i UET]			
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Nga takimi me Dekanen e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, bazuar në RVB dhe “Planin strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH në Studime Religjioze”, programi i studimit është hartuar duke synuar të mbështesë e të nxisë nevojat e zhvillimit ekonomik të vendit. <i>Sidoqoftë, efektivitetin e programit në këtë drejtim do e ndihmonin më shumë si realizimi i një studim paraprak mbi qasjen e nevojat e tregut, ashtu edhe gjetja e formave të duhura për një lobim e marketing më efikas, përse profili është risi e unik në tregun e punës.</i> [ref: Minutat e Vizitës; Planin strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH në Studime Religjioze; RVB]			
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, programi i studimit “Master i Shkencave” në “Studime Religjioze me kriteret, strukturën e përmbajtjen e tij, synon të krijojë “aftësi për kërkim të avancuar e të pavarur shkencor” si dhe “aftësim të plotë për zhvillim karriere, si dhe për vazhdimin e studimeve të doktoratës” [ref: Rregullore MSH-Studime Religjioze]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi I.2

Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe strategjisë së përgjithshme të programit, nga biseda me Përgjegjësen e Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit nga ofrohet ky program si edhe stafin përkatës të programit, rezulton se ai është hartuar në përputhje me misionin e strategjinë përgjithshëm të UET, por edhe me standardet ndërkombëtare. Programi është konceptuar, bazuar në strategjinë e institucionit, për të përgatitur specialistë të nivelit të lartë, ekspertë, të aftë të përshtasin njohuritë teorike dhe praktike me kërkesat e tregut të punës, të ofrojë mësimdhënien me pedagogë të aftë e me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie, me kontribut në fushën akademike, në bashkëpunim me profesorë të ftuar nga universitetet më të mira, etj. Në objektivat strategjike të departamentit e vizionin e tij pasqyrohen, nisur nga strategjia e përgjithshme e institucionit, synimet e masat për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit, evidentuar edhe në procedurat e vetëvlerësimit, rekrutimit të stafit, trainimeve, etj, të kryera në nivel departamenti. Gjithashtu, edhe forcimi i kërkesës ndaj kërkimit shkencor, i angazhimit të studentëve në punën kërkimore, rritjes së cilësisë së mësimdhënies, shtimit të literaturës në gjuhën shqipe etj, janë indikatorë për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies e të nxënit. [ref: minutat e vizites; Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH në Studime Religjoze].
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të Departamentit të Shkencave Humane e Komunikimit në lidhje me kriteret e organizimit e funksionimit të programit të studimit MSH në “Studime Religjoze” si dhe të Statutit, Rregullores e planit strategjik të UET, rezulton se programi aplikohet në përputhje të plotë me to. Ky program është konceptuar në zbatim të objektivit strategjik të institucionit që, duke synuar “ruajtjen e profilizimit të tij kryesor në shkencat ekonomike, financiare, menaxheriale, jurisprudencës, shkencave politike e sociale, edukimit, IT, komunikimit, etj”, të mbetet i hapur ndaj “diversifikimit të ofertës së tij akademike e shkencore dhe në drejtime të tjera që vlerësohen se kërkohen nga tregu i punës”. Hapja e një programi të tillë është një përpjekje për të zgjeruar



	profilin e institucionit me fusha studimi që u përgjigjen nevojave të zhvillimeve dinamike sociale, politike dhe kulturore në vend. [ref: Plani Strategjik 2015-2020; Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH ne Studime Religjoze; Statuti UET; Rregullore UET]
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Programi MSH në “Studime Religjioze” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Me fokus ekspertizën në fushën e çështjeve të sigurisë, krahasimit të feve e marrëdhënieve ndërfitare e kulturore, kuptimit të dimensioneve fetare të kulturave botërore, programi i shërben qëllimit të edukimit liberal për një kurrikul edukative multikulturore e më të plotë informative, nga një qasje krahasese, faktike dhe objektive. Programi, i konceptuar si në emërtim, ashtu edhe në strukturë e organizim brenda një prej fushave e drejtimeve akademike të institucionit, (Shkencave Humane), përbën një përpjekje edukative që synon t’u japë studentëve akses në botën e pasur të filozofive, sistemeve morale, praktikave rituale etj të feve më të rëndësishme, për t’i kuptuar më thellë kulturat botërore si subjekte nxitëse për interesin intelektual. [ref: minutat e vizitës, Argumentimi për hapjen e programit; Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH në Studime Religjoze; syllabuset e programit, RVB]
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	Programi MSH në “Studime Religjioze me profile” është risi për programet “master”, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Qëllimi i hapjes së këtij programi dhe organizimi i tij është konceptuar për t’i shërbyer, nga fokusi i tij i vecantë, zhvillimit të qëndrueshëm e përmbushjes së standardeve dhe progresit në procesin e integritetit evropian. Studimi dhe vlerësimi i rolit të religjioneve e dialogut ndërfitar dhe çështjet e rëndësishme të sigurisë, si profile të programit, zhvillohen në përputhje me interesat kombëtare e trendet globale, duke kontribuar në ndërgjegjësimin dhe edukimin publik për ta parë dialogun ndërkulturor dhe fetar si faktor në parandalimin e konflikteve dhe forcimin e paqes sociale, në krijimin e një klime të bashkekzistencës paqësore ndërmjet feve të ndryshme, në respektimin e dinjitetit njerëzor e forcimin e shoqërisë demokratike.

	[ref: Minutat e Vizitës; Argumentimi për hapjen e programit; Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH në Studime Religjoze; Syllabuset e programit, RVB,]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3

Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Programi i studimit MSh në “Studime Religjoze” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve. Ky program synon ta pajisë studentin me njohuri të thelluara, me aftësim për kërkim të avancuar e të pavarur shkencor duke përvetësuar literaturën kryesore të fushës së studimit, me aftësim të plotë për zhvillim karriere si dhe për vazhdimin e studimeve të doktoratës, por edhe me aftësi e kompetenca profesionale, nëpërmjet zhvillimit të praktikës profesionale. Në rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar qartë edhe mundësitë e punësimit/profesionet përkatëse për të diplomuarit. [ref: Rregullore MSH “Studime Religjoze”; Aneks: Lista e Profesioneve/Mundësive për Punësim pas Përfundimit të Studimeve]
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Mbështetur në takimet e GVJ në institucion (takimi me Dekanen, stafin akademik, grupin e studentëve të diplomuar) si edhe në dokumentacionin përkatës, rezulton se UET ka një përvojë të konsoliduar në marrëdhëniet e komunikimit zyrtar me punëdhënësit e përfaqësues të tregut të punës (në varësi të profileve e fushave akademike që institucioni ofron), në njohjen e kërkesave dhe nevojave të tyre lidhur me mundësitë e punësimit të studentëve. Bordi i Tregut të Punës, anëtarët e të cilit veprojnë në cilësinë e mediatorit midis universitetit dhe tregut të punës, një sërë memorandume e marrëveshje bashkëpunimi me kompani, agjenci, institucione shtetërore e organizata të shoqërisë civile, aktivitete promovuese të UET si panairët e punës, etj, funksionojnë për realizimin dhe zgjerimin e aksesit të studentëve në praktika profesionale e punësim pas diplomimit. Institucioni disponon të dhënat përkatëse edhe për punësimin real të studentëve të diplomuar <i>Sidoqoftë, GVJ ka</i>

	<i>mendimin se, megjithë mundësitë dhe përvojën, në rastin e programit MSH në “Studime Religjose”, si një risi në fushën e profileve master të ofruara, institucioni duhej, paraprakisht, të kishte ndërmarrë një studim tregu si dhe të lobonte shumë më tepër pranë institucioneve shtetërore por edhe atyre private, apo OJF-ve lidhur me qëllimin, përmbajtjen dhe rëndësinë e një masteri të tillë në një terren social-kulturor që ka nevojë reale të përthithë studjues dhe specialistë të këtij profili. Këtë e pranon edhe institucioni: “Universiteti European i Tiranës, në kuadër të hapjes për herë të parë të këtij programi studimi në vitin 2018-2019 nuk ka kryer studim tregu, pasi nuk ka qenë detyrim. Gjithsesi, Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit ka kryer në mënyrë periodike vëzhgime dhe vlerësime të kërkesave të tregut të punës në fushat që mbulon ky program studimi”.</i> [ref: Minutat e Vizitës; Studimi periodik për tregun e punës pas daljes së studentëve; Lista e subjekteve bashkëpunuese për programin dhe praktikat profesionale; Kalendari i aktiviteteve; Bordi i Tregut të Punës; Poster Panairi i Punës; Kontrata dhe Marrëveshje].
Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Nga biseda që GVJ zhvilloi me stafin mësimor të programit, studentët e diplomuar dhe njohja e dokumentacionit, rezultoi se me objektivat formues, strukturën dhe përmbajtjen e programit është synuar në arritjen e dijeve, aftësive dhe kompetencave që i përgatisin studentët për tregun e punës. Studentët e diplomuar treguan për përvojën përgjithësisht pozitive të përfutur gjatë zhvillimit të këtij programi, përfitimet gjatë praktikës profesionale, duke argumentuar rëndësinë e përmbajtjes së tij për t’iu përgjigjur problematikave që dalin nga aktualiteti. [ref: Minutat e Vizitës; Cilësia në hyrje dhe dalje MSH në “Studime Religjose”; Rregullore MSH “Studime Religjose”; Plan i strategjik për zhvillimin MSH në “Studime Religjose”]
Kriteri 4. Programi i studimit përafshohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit të studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	Nga biseda me përgjegjësen e departamentit të shqyrtimit të dokumentacionit të programit, rezultoi se kurrikula e këtij programi, me lëndët përkatëse, i referohet përvojës së universiteteve perëndimore, me qëllim që ta bëjë dijen të transferueshme për t’iu përgjigjur kërkesave të “Kartës së Bolonjës”, në përshtatje edhe me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të dijes. Departamenti ka angazhuar në mësimdhënie, për këtë cikël studimi, personel të kualifikuar, me

	titujt dhe grada shkencore si edhe profesorë më përvojë, duke aplikuar edhe modulet me lektorë të ftuar. Në kuadër të programit Erasmus +, është mundësuar mobiliteti i stafit akademik në universitete të tjera jashtë vendit, për shkëmbim experience. [ref: Minutat e Vizitës; Kurrikula e programit MSH Studime Religjoze; Analiza e Departamentit]
Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disaveçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, bazuar në RVB, konstatohet se programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e direktivat e BE për arsimin e lartë, si dhe mbështetur në përvojën e institucionit; përpara hapjes së këtij programi, UET ka patur një përvojë disaveçare në hapje programesh të këtij cikli. [ref: Urdhër Nr.406, datë 22.08.2011 Për licensimin e programeve të reja të fushës së Shkencave Sociale; RVB]
Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe nga biseda me përgjegjuesin e departamentit e studente të diplomuar, rezulton se UET ka bashkëpunuar nga afër me institucione publike dhe private, si dhe sipërmarrje të ndryshme, pranë të cilave kanë zhvilluar praktikën studentët. Një pjesë e studentëve priren t’i realizojnë praktikatat profesionale pranë qendrave të tyre të banimit dhe UET, megjithëse nuk ka marrëveshje të shkruara, ka rënë dakord me insitucione të caktuara për zhvillimin e praktikës profesionale në qytetet përkatëse. Komuniteti Mysliman i Shqipërise, Qendra e koordinimit kundër ekstremizmit të dhunshëm, Eoman center for development and culture / NGO kanë qënë disa nga institucionet e praktikës profesionale të studentëve të programit MSH Studime Religjoze. [ref: Minutat e Vizitës, Raporti analitik periodik i përfitimeve nga marrëveshtjet e bashkëpunimit]
Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	Bazuar në RVB si dhe në CV-të e personelit akademik të programit, rezulton se programi MSH në Studime Religjoze është licensuar për t’u zhvilluar vetëm në gjuhën shqipe, ndaj elementët e mësimdhënies, modulet e lëndët janë të gjitha në gjuhën shqipe. Sidoqoftë, i gjithë stafi pedagogjik i programit është i aftësuar për të dhënë mësim në gjuhë të huaj, ndërsa brenda këtij stafi ka edhe pedagogë të huaj anglishtfolës. Në prioritetet në bashkëpunimin dhe kooperimin ndërkombëtar, UET synon “të bëhet një qendër e rëndësishme dhe pikë referimi kombëtare e rajonale në kooperimin akademik

		universitar, kërkimin shkencor, aktivitetin botues dhe promovimin e vlerave zhvilluese e qytetare të arsimit të lartë”. Institucioni synon që të jetë “pjesë integrale e rrjeteve dhe strukturave të organizuara institucionale universitare në kuadrin e rajonit të Europës jug-lindore, vendeve të bashkimit European dhe më gjerë vendeve anëtare të OCDE-së”. [ref: Plani strategjik 2015-2020]		
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze		Bazuar në RVB si dhe shqyrtimin e dokumentacionit përkatës, konstatohet se programet e lëndëve ruhen dhe arkivohen pranë zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm. Ato hartohen në gjuhën shqipe si dhe të përmbledhura, në anglisht. Ky dokumentacion është i aksesueshëm edhe në ëeb-in e institucionit. [ref: RVB; Syllabusët e lëndëve]		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvorjen, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Nga biseda me dekanen që mban njëkohësisht dhe pozicionin e përgjegjëses së Departamentit të Shkencave Humane e Komunikimit, konstatohet se institucioni ka angazhuar në mësimdhënie, në këtë cikël studimi, personel të kualifikuar mësimdhënës, me titujt dhe grada shkencore, duke aplikuar gjithashtu modulet me lektorë të ftuar. Në Planin strategjik për zhvillimin e këtij programi, theksohet synimi për të ofruar “mësimdhënien me pedagogë të aftë, me eksperiencë të gjatë..., me kontribut në fushën akademike, në bashkëpunim me profesorë të ftuar nga universitetet më të mira, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit”. [ref: Plani strategjik për zhvillimin e programit MSH Studime Religjoze]
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas	Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, konstatohet se programi MSH në “Studime Religjoze me profile”, që i takon fushës së shkencave humane, është ingranuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore. Programi, me dy profilet përkatëse, Krahësim i Religjoneve dhe Çështje të Sigurisë, ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Humane,

direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Edukimit dhe Arteve Liberale, që përmbledh fusha akademike e kërkimore si Filozofia, Historia, Gjuha, Letërsia, Komunikimi, Mësuesia, etj... [ref: Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse]			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje	Njësia bazë që mbulon programin është departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit. Nga shqyrtimi që GVJ u ka bërë syllabuseve të programit, rezulton përputhshmëri e tij me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. <i>Sidoqoftë, GVJ është i mendimit se si program specifik, në një fushë që nuk ka traditë në studimet akademike dhe kërkimore, pavarësisht brenda hapësirës së shkencave humane, do të kërkonte më shumë personel akademik me background e interesa kërkimore-shkencore në përputhshmëri më të plotë me disiplinat, veçanërisht të fushës së studimit e krahasimit të religjoneve.</i> [ref: Kurrikula e programit MSH Studime Religjoze; Publikimet dhe veprimtaria kërkimore e stafit akademik 2017-2020; CV e stafit të programit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Shkallë e përmesishme	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Bazuar në takimin me dekanen e fakultetit e përgjegjësen e departamentit, si dhe në dokumentacionin përkatës, konstatohet se programi MSH në Studime Religjoze zbatohet në kushtet e ndarjes së detyrave e përgjegjësive mes njësive dhe personelit. Rregullorja e institucionit e aktet e brendshme dispijlojnë institucionalisht marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda tij, duke përcaktuar rolet e përgjegjësive të drejtuesit të njësisë, përgjegjës të grupit mësimor apo koordinatorit të programit. Peshën kryesore për mbarëvajtjen e programit e mban njësia bazë, që monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e mbarëvajtjen e programit.

	[ref: Rregullore UET; Detyrat e koordinatorit të programit; Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe veprimtarinë e Dekanatit dhe Departamentit]
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës të institucionit, rezulton se UET “ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione homologe brenda dhe jashtë vendit...ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional duke përfshirë edhe programet e studimit në Departamentin e Shkencave Humane dhe Komunikimit. Aktualisht, ka 95 marrëveshje (memorandume bashkëpunimi) me IAL në Europë, Amerikë, Australi dhe Kinë dhe, njëkohësisht, gëzon marrëveshje bashkëpunimi me 15 IAL shqiptare publike dhe jo publike”. Gjithashtu një numër marrëveshjesh e memorandumesh janë nënshkruar edhe me aktorë biznesi për zhvillimin e praktikave profesionale. [ref: Raporti periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit]
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Nga biseda me studentë të diplomuar si dhe shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se për realizimin e programit MSH në Studime Religjioze, për komponentin e praktikës profesionale, institucioni ka nënshkruar marrëveshje të posaçme me institucione përkatëse të fushës. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Qendra e koordinimit kundër ekstremizmit të dhunshëm, Eoman Center for Development and Culture, janë institucionet ku është zhvilluar praktika. Kur studentët priren t’i realizojnë praktikat profesionale pranë qendrave të tyre të banimit, ndonëse nuk ka marrëveshje të shkruara, UET ka ndjekur politikën e bashkëpunimit me institucionet përkatëse për realizimin pranë tyre të praktikës profesionale të studentëve. Në traditën e UET është edhe “organizimi i panairit të punës në muajin Maj, në të cilën janë të ftuar OJF, institucione publike dhe private, aktorë të tjerë të rëndësishëm të cilët u ofrojnë studentëve mundësi punësimi ose mundësi internshipi pranë institucioneve të tyre”. [ref: Minutat e Vizitës; Raporti periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit]
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, UET ka marrëveshje zyrtare me një sërë aktorë e institucione për kryerjen e praktikave, në përputhje me natyrën specifike të programit, si me BALFIN, Postën Shqiptare, Fondacionn “Fundjavë Ndryshe”, Bashkinë e Tiranës, Gazetën Liberale, UET Press, Qëndrën e Bashkëpunimit Ndërfetar Elbasan (QBNFE). Në Rregulloren e programit të

	studimit MSH Studime Religjoze pika 7 e saj thuhet se: “Praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyrret nga Drejtuesi i Departamentit, në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës.” Gjithashtu në dokumentin B.I Mbi praktikën profesionale detajohet procesi i realizimit dhe mbikëqyrjes së praktikës mësimore. Konkretisht pika B.I 3 përcakton se: “Strukturat përgjegjëse për zhvillimin dhe vlerësimin e praktikës janë: Departamenti dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës. Sipas këtij dokumenti, Departamenti harton silabusin e zhvillimit të praktikës në auditor, dhe kalendarin e zhvillimit të seancave; realizon përzgjedhjen e ekspertëve të fushës që do të referojnë në auditor në seancat e programuara për çdo program studimi, të cilët duhet të jenë anëtarë të Bordeve të Tregut të Punës, ose UET Alumni; përzgjedh dhe kontakton institucionet ku do të kryhen vizitat studimore në grup; mbikëqyr dhe ndjek seancat me ekspertët e ftuar në auditor, duke caktuar një pedagog përgjegjës për çdo program studimi (si rregull caktohet pedagogu me statusin e këshilluesit të karrierës, i cili është përgjegjës edhe për zhvillimin e seancave të zhvillimit profesional dhe karrierës në auditor). Departamenti mbikëqyr dhe ndjek vizitat studimore të studentëve dhe kryerjen e praktikës në institucionet pritëse, duke caktuar pedagogun mbikëqyrës për çdo program studimi apo student. Gjithashtu në këtë proces një rol të rëndësishëm luan dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës, nëpërmjet parapërgatitjes së studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënies së informacionit e asistencës së nevojshme studentëve për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave profesionale/stazheve/internshipeve të ofruara nga institucione partnere e më gjerë etj. [ref: Rregullore e programit të studimit MSH Studime Religjoze; Lista e subjekteve bashkëpunuese për programin dhe praktikat profesionale; B.I Mbi praktikën profesionale]
Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se UET ka marrëveshje bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm insitucionesh homologe e institute kërkimore shkencore në Austri, Belgjikë, Bosnje Herzegovinë, Francë, Gjermani, Republika Ceke, Finlandë, Qipro, Itali, Hungari, Angli, Kosovë, Lituani etj, për shkembime stafi e studentësh, ngritje kapacitetesh, projekte e programe të përbashkëta, shkëmbim vizitash e programesh kulturore e institucionale etj. Shumë aktivitete organizohen në kuadër të projekteve Tempus, Erasmus + KA2 etj. Marrëveshje

	bashkëpunimi e partneriteti janë nënshkruar edhe me institucione vendase të arsimit të lartë apo institucione të shoqërisë civile e ndërkombëtare si partner/donator. Pranë institucionit funksionon për këtë qëllim Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve, në funksion të hartimit e menaxhimit të projekteve ndërkombëtare, partneriteteve strategjike dhe lehtësimit të alikimeve për grante kërkimore. [ref: Marrëveshje bashkëpunimi UET; RVB]			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit përkatës, rezulton se lidhur me zhvillimin e praktikës, institucioni bazohet në dokumentin përkatës, ku janë detajuar treguesit e qëllimit, përmbajtjes e zhvillimit të procesit, struktura përgjegjëse, ngarkesa mësimore, kërkesa ndaj institucionit ku zhvillohet praktika, vlerësimi dhe detyrimet e studentit për këtë komponent të procesit mësimor. Gjithashtu, departamenti harton raport analitik periodik për përfitimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit, ndërsa një dokument i detajuar është edhe formulari i vetëvlerësimit, që plotësohet nga studenti, pas praktikës, me tregues domethënës mbi mundësitë e krijuara, përfitimet dhe efikasitetin e kësaj veprimtarie. [ref: Minutat e Vizitës; Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale; Raporti periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; B.I.4 Formulari i vetëvlerësimit të praktikës]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi L.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit përkatës, rezulton se në strategjinë e kërkimit shkencor të UET përfshihet edhe mbështetja e produktivitetit kërkimor shkencor të personelit akademik e studentëve. UET synon të konsolidojë identitetin e universitetit si qendër e prodhimit të dijes në Shqipëri e të transformohet nga një institucion i arsimit të lartë i fokusuar në mësimdhënie, në një institucion elitare kërkimor, produkti kërkimor i të cilit kërkohet nga tregu dhe përmirëson në vazhdimësi mësimdhënien dhe

	eksperiencën studentore në UET”. Kërkimi shkencor në UET është konceptuar në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies e mësimnxënies, nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore. Institucioni është përpjekur të përmirësojë në vazhdimësi infrastrukturën e kërkimit shkencor, për t’i dhënë frymëmarrjen e duhur punës studimore të stafit akademik. Parashikohet vendosja në dispozicion të stafit akademik të një fondi kërkimor për mbështetje për ndërmarrjen e projekteve kërkimore ose për shpërblim pas publikimit në revista dhe libra të botuara nga shtëpi botuese me reputacion. Projektet e Mëdha Kërkimore përbëjnë shtyllën e kërkimit shkencor e janë instrumenti kryesor i drejtimit dhe gjenerimit të punimeve dhe botimeve shkencore në UET. Revistat Polis, Medicus dhe Economicus janë instrumenti kryesor botues i komunitetit akademik, ndërsa nëpërmjet shtëpisë botuese UET Press është kontribuar në pasurimin e botimeve në Shqipëri me përkthime të veprave klasike dhe me botime origjinale shkencore të autorëve shqiptarë. Konferenca “Ditët e Studimeve Shqiptare”, Anuarët e Filozofisë, Rrethi Liberal i Dardhës dhe Ditët e Letërsisë janë disa nga takimet e debatet e rëndësishme shkencore për promovimin e mëtejshëm të filozofisë, letërsisë dhe mendimit liberal. [ref: Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020; Ditët e Studimeve Shqiptare; Kalendar i aktiviteteve]
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Bazuar në dokumentacionin e institucionit, rezulton se, me qëllim zhvillimin dhe mbështetjen e kërkimit shkencor, institucioni ka ngritur struktura të posaçme që planifikojnë dhe drejtojnë atë. Zhvillimi strategjik i kërkimit shkencor drejtohet nga Zv. Rektori për Çështjet Akademike dhe Senati Akademik, të cilët monitorojnë dhe vlerësojnë ndërtimin e SKSH-së me një vizion afatmesëm dhe afatgjatë, mbikëqyrin zbatimin e saj dhe përditësojnë prioritetet e kërkimit shkencor në përputhje me synimet e UET. Fakultetet dhe Departamentet janë njësitë kryesore që, në nivelet përkatëse, realizojnë menaxhimin e kërkimit shkencor. Institucioni pajis e përmirëson në mënyrë të vazhdueshme dhe cilësore edhe infrastrukturën e nevojshme për këtë qëllim. [ref: Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020; Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025]

Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Sipas bisedës me dekanen dhe përgjegjësen e departamentit, nga takimi në zyrën e burimeve njerëzore dhe shqyrtimi i dokumentacionit e RVB, rezulton se UET zhvillon në mënyrë të vazhdueshme mekanizma të menaxhimit të stafit akademik në mbështetje të kërkimit shkencor dhe monitorimit të performancës, duke mbajtur parasysh edhe zhvillimet në institucionet homologe. Këtij qëllimi i shërben përcaktimi i Indikatorëve të Performancës së Kërkimit Shkencor. Në formularin e vetëvlerësimit të performancës së stafit akademik, promovohen dhe vlerësohen si indikatorët kryesorë në fushën e kërkimit shkencor: artikuj shkencorë të botuar në revista ndërkombëtare e revista të UET, artikuj shkencorë të botuar në revista me faktor impakti, pjesëmarrje në konferenca shkencore brenda vendit, në hapësirën mbarëshqiptare apo në vendet e OECD, pjesëmarrja në projektet kërkimore, libra të botuar, recensione për botime, etj. (Institucioni ka krijuar, nga ana e tij, hapësira, mundësi e infrastrukturë për promovimin dhe publikimin e produktit kërkimor). [ref: Minutat e Vizitës; Publikimet dhe veprimtaria kërkimore e stafit akademik 2017-2020; Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik]
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Nga shqyrtimi i Kodit të Etikës së UET, rezulton se institucioni mbështet standardet më të larta të integritetit, të ndershmërisë morale dhe të përgjegjësisë së komunitetit universitar, zbatimin e standarteve të kërkimit shkencor, duke garantuar objektivitetin dhe rigorozitetin shkencor, shmangjen e çdo qëndrimi të njëanshëm, shmangjen e plagjiaturës dhe çdo formë tjetër e vjedhjes së pronësisë intelektuale, që konsiderohet e ndëshkueshme. Në përgjithësi, institucioni ndjek dhe inkurajon politikën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale, si edhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese. [ref: A.II.Kodi i Etikës]
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Nga biseda me përgjegjësen e departamenti, stafin mësimor dhe studentët e programit si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se institucioni i jep rëndësi punës së pavarur kërkimore të studentëve. Lëndët specifike, detyrat e kursit, realizimi i projekteve kërkimore lëndore, përgatitja e temës së diplomës, praktika profesionale, pjesëmarrja dhe bashkëpunimi në punën kërkimore të pedagogut, etj janë drejtime ku realizohet aftësimi i tyre për punë kërkimore-shkencore. Për kërkuesit e rinj, përveç mbështetjes në një program të strukturuar doktorat, i cili është thelbësor për edukimin metodologjik të doktorantëve, ofrohen

	trainime për t'u mundësuar doktorantëve përfitim të aftësive të nevojshme si kërkues të suksesshëm dhe kontribues aktivë në jetën akademike të UET Trainime përshikohen edhe për Junior Researchers, si pjesë integrale e stafit akademik që duhet t'u përgjigjen kërkesave në rritje, të ndërkombëtarizuara të kërkimit, veprimtarisë e botimeve shkencore. [ref: Minutat e Vizitës; Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020; Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1

Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga shqyrtimi i dokumentacionit që lidhet me programin MSH në Studime Religjose dhe RVB, rezulton se ky program studimi është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara me kredite. Lëndët bazë, lëndët karakterizuese dhe ato ndërdisiplinore/integruese kanë 6 kredite; praktika profesionale 12, ndërsa diploma 18 kredite, duke plotësuar 180 kredite, bazuar në udhëzimin e MASR, legjislacionit vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). [ref: Kurrikula e programit MSH Studime Religjose]
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit që lidhet me programin MSH në Studime Religjose dhe RVB, rezulton se ky program është hapur në vitin akademik 2018-2019 në Departamentin e Shkencave Humane dhe Komunikimit, pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, me kohëzgjatje normale 2 vjecare (4 semestra). Programi u licensua me 5 profile, por me vendim të Senatit Akademik, 17.12.2020, pasi u shqyrtua ecuria e numrit të studentëve, u miratua mbyllja e tre profileve. Programi funksionoi me profilet “Krahasimi i Religjoneve” dhe “Çështje të Sigurisë”. Përmbajtja e njohurive në këtë program synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh, në përmbushje të kriterëve dhe në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për programet e studimit të ciklit Master Shkencor. Mbajtësi i diplomës është i aftë të përdorë instrumentat dhe metodat e kërkimit në analizën, krahasimin dhe studimin e feve, çështjeve të sigurisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, si edhe në kuadër të debateve bashkëkohore në shkencat sociale dhe humane. Njohuritë e programit i mundësojnë mbajtësit të diplomës aftësitë dhe shprehjet për të identifikuar e zhvilluar platformat e komunikimit dhe të adresimit të çështjeve fetare ose ato të sigurisë. [ref: Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH në Studime Religjose; UMASR Nr.688 datë 15.10.2018 “Për hapjen e e programit MSH Studime Religjose, UET”]

Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfaqësohet të kuptuarit kritik të teorisë dhe parimeve akademike të fushës.	Bazuar në rregulloren e programit MSH në Studime Religjose, nga biseda me stafin akademik dhe studentët e diplomuar, rezulton se ky program synon të japë një qasje të thelluar, të zgjeruar dhe të specializuar të koncepteve, formim tematik dhe aftësi për kërkim të avancuar e të pavarur shkencor, përvetësim të literaturës kryesore të fushës së studimit dhe aftësim të plotë për zhvillim karriere. Në zhvillimin e lëndëve të programit është synuar qasja kritike e teorisë dhe parimeve akademike të fushës së studimit. [ref: Minutat e Vizitës; Syllabusët e programit; Rregullore MSH Studime Religjose]
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Bazuar në dokumentacionin përkatës mbi programin e biseda me stafin akademik, rezulton se qëllimi është “t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke u bazuar jo vetëm të kërkimi shkencor, por edhe tek njohuritë praktike dhe teknike, nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, aftësimit për përdorimin e arritjeve më të mira të shkencës, si dhe forcimit të partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare”. Me fokus fushën e religjoneve e çështjet e sigurisë, programi ofron njohuri, aftësi dhe kompetenca të thelluara në kushtet e rëndësishme të dialogut ndërfetar në Shqipëri e problemeve komplekse të lidhura me sigurinë në rrafsh kombëtar e ndërkombëtar, si probleme aktuale që kërkojnë analizen e ekspertizën përkatëse. [ref: Minutat e Vizitës; RVB; Plani strategjik për zhvillimin e programit MSH në Studime Religjose]
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, syllabuseve të lëndëve, rezulton se programi MSH në Studime Religjose i përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit. Rregullorja mësimore e programit mbështetet në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” si dhe në Statutin dhe Rregulloren Mësimore të UET. Rregullorja “është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij.” Ajo përcakton aspektet organizative të programit MSH dhe “është hartuar duke respektuar lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve”. [ref: Rregullore MSH Studime Religjose]



Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndë / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga shqyrtimi i rregullores së programit e syllabuseve të lëndëve rezulton se në strukturën e programit janë të qarta ndarjet e veprimtarive formuese që ofrohen në këtë program studimi. Ato grupohen në 5 kategori: A. Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (12 ECTS); B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (60 ECTS); C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje. (18 ECTS); D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale. (12 ECTS); E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës (18 ECTS). [ref: Rregullore MSH Studime Religjoze]			
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	Referuar rregullores së programit të studimit dhe dokumentacionit që lidhet me procedurën e realizimit të diplomës, konstatohet se punimi i diplomës, me 18 kredite është detyrimi përmbyllës në veprimtaritë formuese të programit. Në dokumentin e institucionit mbi punimin e diplomës, përcaktohen qartë kriteret lidhur me strukturën, tematikën, metodologjinë dhe burimet për realizimin e punimit, procedura e aplikimit e miratimit, përcaktimit të udhëheqësit mbi bazën e ekspertizes përkatëse, zhvillimi i seancave metodologjike, aftësitë e transferueshme të studentit, etj. [ref: Rregullore MSH Studime Religjoze; Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Referuar dokumentacionit të institucionit dhe RVB, konstatohet se Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, përgjegjës për programin MSH në Studime Religjoze, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Ai është njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale i krijuar me VKM Nr. 636, datë 20.09.2006 dhe i riorganizuar me Urdhër Ministri Nr.528, datë 04.09.2018. UET është institucion i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit

	Nr.12, datë 07.04.2017 dhe pas riorganizimit me vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.46, datë 05.07.2019. [ref: Vendim i BA Nr.12, datë 07.04.2017; Vendim i BA Nr.46, datë 05.07.2019; UMASR Nr.688 datë 15.10.2018 “Për hapjen e MSH Studime Religjose, UET”; RVB]
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale përbush detyrimet ligjore e nënligjore për organizimin e strukturën akademike. Përbëhet nga 3 departamente fakultete dhe është përgjegjës për një numër programesh studimi (22 gjithsej: BSc, MSc/MA, MP). [ref: Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse]
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit është përgjegjës për programin MSH në Studime Religjose. Përgjatë vitit 2018-2019 në njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi përbëhej nga 16 personel akademik me kohë të plotë përkatësisht: 1 Prof. Dr., 3 Prof. Asoc, 8 Dr. dhe 4 Msc dhe personeli akademik me kohë të pjesshme janë angazhuar 14 përkatësisht: 1 Prof. Dr., 4 Prof. Asoc., 4 Dr, 1 PhD, 4 Msc. Në vitin 2019-2020 u angazhuan 12 personel akademik me kohë të plotë (1 Prof. Dr., 3 Prof. As., 4 Dr, 4 Msc) dhe 13 personel me kohë të pjesshme (2 Prof. As., 8 Dr, 3 Msc). Në vitin 2020-2021 u angazhuan 10 personel akademik me kohë të plotë (3 Prof. As., 3 Dr, 4 Msc) dhe 3 personel me kohë të pjesshme (3 Dr.). Gjatë vizitës në institucion në zyrën e burimeve njerëzore dosjet e personelit akademik si me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme ishin të plota. Institucioni kishte një dokumentacion të ruajtur dhe të përditësuar me të dhënat e stafit akademik i cili ishte i angazhuar në kuadër të këtij masteri. Nga analiza e GVJ evidentohet fakti që janë ruajtur raportet e përfshirjes së stafit PAE/PAK në përqindjen 70% PAE dhe 30% PAK. Kjo konfirmohet dhe në dokumentin Analiza e Departamentit ku shkruhet se: “Pesha specifike e pedagogëve të jashtëm ndaj pedagogëve efektivë është gjithashtu brenda kritereve”. Përsa i takon raportit personel akademik efektiv/ student në nivel njësie bazë, është 1: 6 (për vitin akademik 2019-2020). Departamenti është strukturuar në grupe mësimore, me anëtarë të departamentit sipas lëndëve të përafërta e përgjegjësat përkatës. [ref: Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit; Analiza e Departamentit; Vizita në Institucion]

Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Në statutin e UET përcaktohet departamenti, si “njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies e punës kërkimore-shkencore”, “përgjegjës për programin e studimit që ofron”. Mënyra e organizimit dhe e veprimtarisë së departamentit si edhe detyrat e tjera të tij përcaktohen mbështetur në ligjin për Arsimin e Lartë dhe rregulloren e institucionit. [ref: Statuti UET; Rregullore e UET; Ligji 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH]
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	Departamenti, si njësia përgjegjëse për programin e studimit, është gjithashtu struktura përgjegjëse për realizimin e praktikave mësimore harton syllabusin e zhvillimit të praktikës në auditor dhe kalendarin e zhvillimit të seancave, përzgjedh ekspertët e fushës që do të referojnë në auditor në seancat e programuara për çdo program studimi, të cilët duhet të jenë anëtarë të Bordeve të Tregut të Punës, ose UET Alumni, përzgjedh dhe kontakton institucionet ku do të kryhen vizitat studimore në grup, ndjek seancat me ekspertët e ftuar në auditor, duke caktuar një pedagog përgjegjës për çdo program studimi (si rregull caktohet pedagogu me statusin e këshilluesit të karrierës, i cili është përgjegjës edhe për zhvillimin e seancave të zhvillimit profesional dhe karrierës në auditor). Departamenti mbikëqyr dhe ndjek vizitat studimore të studentëve dhe kryerjen e praktikës në institucionet pritëse, duke caktuar pedagogun mbikëqyrës për çdo program studimi apo student, shpërndan dhe mbledh dokumentacionin e praktikës profesionale për çdo student e propozon përbërjen e Komisionit të Vlerësimit të praktikave, i cili bën vlerësimin. Në institucion funksionon edhe Zyra e Këshillimit të Karrierës, që parapërgatit studentët për procesin e praktikave profesionale dhe jep informacion e asistencë të nevojshme për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave profesionale, stazheve apo internshipeve. [ref: Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit; Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale]
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në bazë të vendimit të Dekanit, datë 03.12.2018 për programin MSH në Studime Religjose është caktuar personi përgjegjës në rolin e koordinatorit, që ndjek ecurinë dhe zhvillimin e kurrikulës së programit, shqyrton hartimin e syllabuseve të lëndëve në përputhje me standartet dhe kriteret e insitucionit, ka përgjegjësi për përcaktimin e materialeve bibliografike dhe informatike të nevojshme në mësimdhënie, miraton tezat e provimeve dhe temat e kursit, ndjek ecurinë dhe zhvillimin e praktikave profesionale

	duke mbajtur kontaktin me institucionet bashkëpunuese, monitoron përputhshmërinë e kurrikulës me nevojat tregut e të rejtat e fundit të shkencës në bashkëpunim me Bordet e Tregut të Punës e Qendrat apo grupet kërkimore përkatëse. [ref: Minutat e Vizitës; Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit FSHHEAL detyrat e koordinatorit]			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Bazuar në takimin me përgjegjësen e departamentit e dokumentacionit përkatës, rezulton se koordinatori i programit, përgjegjës për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e kurrikulës së programit, raporton në mënyrë periodike, për të gjitha problematikat dhe ecurinë e tij, tek përgjegjësi i departamentit dhe në mbledhjet e njësisë bazë. [ref: Minutat e Vizitës; Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit FSHHEAL, detyrat e koordinatorit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Shtesë shprehjet e	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni disponon informacionet e nevojshme mbi programin e studimit, strukturën, përmbajtjen dhe organizimin e saj. Statuti e rregullorja e institucionit, kurrikula e rregulloret e programeve të studimit, syllabuset e lëndëve, planet mësimore, marrëveshjet me punëdhënës, institucione e agjenci për zhvillimin e praktikave, me institucione homologe ndërkombëtare, lista e publikimeve dhe veprimtarisë kërkimore, dokumentet për funksionimin e strukturave mbështetëse të institucionit, etj janë të depozituara dhe kanë akses për anëtarët e njësive kryesore e bazë. Gjithashtu në efikasitet të plotë është edhe platforma UET LMS (sistemi i menaxhimit online të mësimdhënies) me të gjitha funksionet e tij, si ngarkimi i literaturës për çdo lëndë, njoftimet e pedagogut, pikët e vlerësimit, dërgimi i detyrave dhe eseve nga studentët, etj. Edhe në ëeb-in e UET gjenden të dhënat e detajuara lidhur me programet e studimit. [ref: Urdhër për zbatimin e platformës LMS; RVB]

Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i rregullores dhe kurrikulës së programit MSH në Studime Religjose, GVJ konstaton se ai është plotësuar bazuar në kriteret përkatëse, i organizuar me lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, lëndët plotësuese (praktikë profesionale), e detyrimet përmblyllëse, aktivitetet formuese etj. [ref: Rregullore MSH Studime Religjose; Kurrikula e programit MSH Studime Religjose]
Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit MSH në Studime Religjose, GVJ konstaton se lëndët dhe modulet e programit janë të vlerësuara më kredite, sipas sistemit vendas dhe evropian, të ndara në 4 semestra me kohëzgjatjen 2 vjetare e që plotësojnë numrin total të 120 krediteve. [ref: Plani mësimor i programit MSH në Studime Religjose]
Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Nga shqyrtimi i rregullores e planit mësimor të programit MSH në Studime Religjose, GVJ vëren se në to përmbahet informacioni i duhur për ngarkesën mësimore, orët brenda dhe jashtë auditorit, ngarkesa totale e ndarë në leksione, seminare, ushtrime/projekt/detyra, praktike e punim diplome, format e kontrollit të njohurive, elementët ku bazohet nxjerrja e notës përfundimtare. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtme: a. Provimit të ndërmjetëm (30%) b. Nivelit të diskutimit (10%) c. Detyrës së kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike (20%) d. Provimit përfundimtar (40%). [ref: Rregullore MSH Studime Religjose; Plani mësimor i programit MSH në Studime Religjose; Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB; Dokumenti.A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve]
Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Nga shqyrtimi i Rregullores së programit të studimit e dokumentave të tjera të posacme, GVJ konstaton se në to studentët mund të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithëshme dhe specifike të pranimit, transferimit, njohjes së krediteve dhe kushteve të mobilitetit të studentëve. [ref: Rregullore MSH Studime Religjose; Dokumenti D.II Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin]
Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore	Nga shqyrtimi i rregullores e syllabuseve të lëndëve të programit të studimit MSH në Studime Religjose, GVJ konstaton se ato i përmbahen VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për

(syllabusët e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL (ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019). Format i syllabusit të lëndës dokumenton në mënyrë të detajuar informacionin mbi rezultatet e pritshme të të nxënit, konceptet themelore, temat shoqëruar me literaturën e detyruar dhe të rekomanduar, kushtet e frekuentimit, formën e kontrollit të djes dhe komponentet e tjerë formues të programit. [ref: Rregullore MSH Studime Religjioze; Format i syllabusit Cikli i parë dhe i dytë; Syllabusët e lëndëve]			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	Bazuar në rregulloren e programit të studimit, GVJ konstaton se ajo parashikon rishikim në mënyrë periodike të programit të studimit me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm: “Rishikimi i programit mund të parashikojë bashkime lëndësh ose ndarje të tyre, por pa cenuar raportet e përcaktuara për secilën kategori disiplinash në program, rishikimin e krediteve të lëndëve, të teksteve që do të përdoren por edhe të literaturës”. Ndryshimet propozohen nga Departamenti, Zyra e Kurrikulave, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me Bordet e Tregut të Punës. Si rregull, rishikimi mund të bëhet vetëm para fillimit të vitit akademik. [ref: Rregullore MSH Studime Religjioze]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të ciklit të dytë MSH në Studime Religjioze, konstatohet se ngarkesa e tij është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi e udhëzimet e MASR. Programi ofrohet me kohëzgjatje normale dy vite akademike (4 semestra) dhe përmbush kushtin e realizimit me jo më pak se 120 kredite. Në përfundim të ciklit lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në “Studime Religjioze”, me profile “Krahasimi i Religjioneve”, “Çështje të Sigurisë”.

	[ref: Plani mësimor i programit MSH në Studime Religjoze; Analiza e departamentit; Ligj Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”]
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të ciklit të dytë MSH në Studime Religjoze, konstatohet se emërtimi e përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe punësimin e studentëve. Ato janë të organizuara në 5 kategori (A-E), si: lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, me vlerësimin përkatës në orë mësimore e kredite. [ref: Plani mësimor i programit MSH në Studime Religjoze; Analiza e departamentit]
Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës dhe kërkimit shkencor.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të ciklit të dytë MSH në Studime Religjoze, konstatohet se shpërndarja e lëndëve në vite e semestra, me kreditet e orët mësimore përkatëse, përputhet me përcaktimet ligjore në fuqi dhe është në funksion të objektivave formues të programit e rezultateve të pritshme të të nxënës dhe aftësisht profesional. [ref: Plani mësimor i programit MSH në Studime Religjoze; Analiza e departamentit; Ligj Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”]
Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të ciklit të dytë MSH në Studime Religjoze, konstatohet se Struktura e programeve, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë janë hartuar për të realizuar objektivat e profilit të programit. <i>Sikundër u trajtua nga anëtarët e GVB ky program është unik dhe nuk ka përafërsi me programe të ngjashme ndërkombëtare.</i> [ref: Takimi me GVB; Minutat e Vizitës; Plani mësimor i programit MSH në Studime Religjoze; Analiza e departamentit]
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të ciklit të dytë MSH në Studime Religjoze, konstatohet se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik i shërben arritjes së objektivave formuese, transferimit të studimeve, mobilitetit dhe punësimit në përfundim të studimeve. “Parimet e ndërtimit të programit të lëndës janë: 15% të programit e zënë njohuritë bazë dhe konceptet e lëndës në përputhje me objektivat e ciklit të parë; 70% të programit e

	zënë njohuritë e thelluara, të aplikuara dhe krahasuese në lëndë, në përputhje me informacionin që duhet të jepet në ciklin e dytë; 15% të programit e zënë analiza e thelluar dhe kritika e teorisë dhe aplikimeve të fushës, në përputhje me informacionin e ciklit të tretë. Literatura, përveç karakterit gjithëpërfshirës duhet të jetë veçanërisht e fokusuar në prezantimin e shkollave dhe qasjeve të ndryshme të asaj fushe”. Lidhur me mobilitetin e studentëve, <i>numri i tyre në MSH Studime Religjioze ka qenë i pakët për vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-2020 dhe nuk ka patur studentë nga ky program që kanë kryer shkëmbim në një vend të BE-së.</i> [ref: Plani mësimor i programit MSH në Studime Religjioze; Analiza e departamentit; Raporti periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës]
Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstaton se disa prej tyre bazohen në literaturë të detyruar e ndihmëse të viteve të fundit, botuar nga shtëpi botuese prestigjioze. [ref: Syllabuset e lëndëve]
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	Nga shqyrtimi i syllabuseve të programit MSH në “Studime Religjioze”, GVJ konstaton se, me përmbajtjen e tyre, ato synojnë përfitim të dijeve, aftësive e kompetencave që ka si objektiva programi. <i>Sidoqoftë, GVJ konstaton se një pjesë e syllabuseve të programit, pavarësisht nga formulimi e formati korrekt e në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, nuk janë përgatitur posaçërisht për programin në fjalë, duke qënë të njëjtë edhe në programe “Master Profesional” dhe “Master Shkencor” të profileve të tjera. Kjo shfaqet në zërin Titulli i Programit të Studimit, ku nuk figuron titulli përkatës i programit të studimit (MSH në Studime Religjioze,) por tituj të tjerë masterash si: Organizata Ndërkombëtare, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Master në Gazetari, Master në Shkenca Politike, Studime të Sigurisë, etj ose në mënyrë më të përgjithëshme MP/MSH, pa asnjë përcaktim. Nga shqyrtimi edhe i përmbajtjes së këtyre syllabuseve rezulton se, në disa raste, tematika e tyre nuk është e profilizuar e në përshtatjen e plotë me profilin e programit MSH në Studime Religjioze.</i> [ref: Syllabuset e lëndëve]
Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e	Nga takimi me studentë të diplomuar të programit si dhe shqyrtimi i përmbajtjes së programit MSH Studime Religjioze dhe syllabuseve të lëndëve, GVJ konstaton se ky program u

studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	ofron studentëve njohuri të specializuara dhe të thelluara në fushën e krahasimit të religjoneve dhe çështjeve të sigurisë, siç është strukturuar e profilizuar programi, duke u dhënë mundësi studentëve të marrin baza për të vijuar me studime të mëtejshme, apo të shfrytëzojnë aksesin në tregun e punës. <i>GVJ ka mendimin se, bazuar edhe në rekomandimet që lanë ekspertët për licensimin e programit, të cilët kanë sugjeruar që “të paktën një lëndë të përbëhet nga historiku i dialogut ndërfaqetor përgjatë historisë në botë dhe në Shqipëri, si dhe të ketë një modul lidhur me historikun e komuniteteve fetare në Shqipëri, legjislacionin e tyre zyrtar dhe marrëdhëniet me shtetin shqiptar”, syllabuse të caktuara mund të përmirësohen për një hapësirë e adresimin më të mirë, problematikave të aktualitetit shqiptar, brenda kontekstit të përmbajtjes e profilizimeve të programit. Kësaj kërkesë, për lëndë të caktuara, iu adresuan edhe studentët gjatë takimit me GVJ. [ref: Minutat e Vizitës; Adresimi i rekomandimeve të hapjes së programit; Syllabuset e lëndëve]</i>
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Nga takimet me përgjegjësen e departamentit, studentët e diplomuar dhe shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se me anë të këtij programi studenti ka mundësinë të ndjekë një drejtim specifik me natyrë praktike dhe të zhvillojë njohuritë profesionale. Në tërësi, për organizimin e programeve të studimit dhe të planeve mësimore, UET konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve përkatëse, të organizuar në formën e Bordeve të Tregut të Punës në nivel Departamenti, për t’iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Bordet e tregut të punës, që janë integruar tashmë në strukturat e institucionit, kanë kontribuar në praktikën e studentëve, duke u bërë pjesë e auditoreve në formën e profesionistëve të ftuar, si dhe kanë kontribuar me përvojën e tyre për modelimin e syllabuseve dhe programeve, në përshtatje me nevojat e tregut. <i>Sidoqoftë, bazuar edhe në rekomandimin e ekspertëve për licensimin e programit, GVJ konfirmon nevojën e “një studimi mbi nevojat specifike të tregut për të diplomuarit e këtij programi” që, sëbashku edhe më një fushatë më të mirë marketingu e promovimi pranë institucioneve e agjencive të interesuara shtetërore, private apo organizatave të shoqërisë civile, të nxisi rritjen e numrit të studentëve në këtë program (numri i</i>

	<i>studentëve gjithsej në këtë program studimi ka qënë 7 dhe 4 janë aktualisht të diplomuarit).</i> [ref: Minutat e Vizitës; Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale; Adresimi i rekomandimeve të hapjes së programit]		
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Nga shqyrtimi i dokumentacionit e RVB, konstatohet se hartimi dhe konceptimi i kurrikulës së programit, me ndarjet përkatëse të orëve, kombinimin e veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, jep bazat e njohurive të fushës së studimit, që mund të avancohen nëpërmjet kërkimeve, analizave e thellimit të aktivitetit kërkimor shkencor. Rëndësia e kërkesa që stafi akademik i programit i kushton punës së pavarur kërkimore të studentëve nëpërmjet detyrave të kursit, punimit të diplomës edhe formave të tjera të veprimtarisë kërkimore, mundësojnë përgatitje dhe aftësi edhe për ndjekjen, nga ana e studentëve, të ciklit të tretë të studimeve. [ref: Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës; Kurrikula e programit MSH në Studime Religjoze; Plani mësimor MSH Studime Religjoze; RVB]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i CV-ve e veprimtarisë kërkimore - shkencore e botuese të personelit akademik, me kohë të plotë e të pjesshme të programit MSH në Studime Religjoze, rezulton se Departamenti ka angazhuar në mësimdhënie personel të kualifikuar, me tituj dhe grada shkencore, profesorë me përvojë akademike, duke aplikuar edhe modulet me lektorë të ftuar. Pjesa më e madhe e personelit të brendshëm janë të angazhuar në kërkim shkencor dhe janë drejtues grupesh kërkimore. [ref: CV të stafit mësimor të programit; Publikimet dhe veprimtaria kërkimore e stafit akademik 2017-2020]

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i CV-ve, e veprimtarisë kërkimore - shkencore e botuese të personelit akademik, me kohë të plotë e të pjesshme të programit MSH në Studime Religjose, rezulton se zhvillimi i tij realizohet nga një staf pedagogjik me përvojë dhe i kualifikuar, me tituj dhe grada shkencore, profesorë me përvojë akademike, me rol në jetën publike, e disa edhe në jetën fetare të vendit. Konkretisht, përgjatë vitit 2018-2019 në këtë program studimi janë angazhuar 8 personel akademik me kohë të plotë përkatësisht: 2 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc, 3 PhD. dhe 1 Dr. Personeli akademik me kohë të pjesshme ka qënë 3 përkatësisht: 1 Prof. Asoc. Dhe 2 Dr. Në vitin 2019-2020 u angazhuan 7 personel akademik me kohë të plotë përkatësisht: 2 Prof. Dr., 2 Prof. as., 2 Dr, 1 Msc dhe 1 personel akademik me kohë të pjesshme (Dr.) por që mbulonte 2 lëndë në program. <i>Sidoqoftë, GVJ, sugjeron që, në rastet kur programet e studimit janë të profilizuara në fusha të reja për aktivitetin kërkimor e akademik, kërkohet që ekspertiza akademike e kërkimore-shkencore të përputhet apo të jetë më e profilizuar për fushën e vecantë, në këtë rast, të studimit e krahasimit të religjoneve. Kjo evidentohet edhe nga interesat kërkimore dhe veprimtaritë shkencore te stafit, që, në përgjithësi, nuk është e drejtuar vecanërisht tek fusha e studimit dhe krahasimit të religjoneve.</i> [ref: Analiza e Departamentit; CV të stafit mësimor të programit; Publikimet dhe veprimtaria kërkimore e stafit akademik 2017-2020]
Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Bazuar në shqyrtimin e CV-ve, dhe veprimtarisë kërkimore-shkencore si dhe botuese të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, <i>GVJ, duke vlerësuar personalitetin, profilin akademik dhe shkencor të anëtarëve të stafit e kontributet përkatëse, ka mendimin se, duke qënë një program i ciklit të dytë, specifik dhe i ri në fushën e studimeve akademike e shkencore, Departamenti mund të ishte paraprakisht më i përgatitur për personel me kualifikim të posaçëm në fushën e Studimeve Religjose.</i> [ref: CV të stafit mësimor të programit; Publikimet dhe veprimtaria kërkimore e stafit akademik 2017-2020]
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e	Nga biseda me dekanen e përgjegjësen e departamentit dhe shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se UET ka një traditë disavjecare që, për realizmin e programeve të ciklit të dytë MP dhe MSH, nënshkron marrëveshje të posaçme dhe zgjeron bashkëpunimin me institucione, organizata dhe shoqata

studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	të ndryshme të shoqërisë civile, për realizimin e praktikave profesionale. Me anë të Zyrës së Karrierës dhe Praktikave, lidhen memorandume bashkëpunimi me shumë institucione publike dhe kompani private, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar realizimin e praktikave profesionale të studentëve në këto institucione. Me programin e studimit MSH në Studime Religjose, studenti ka mundësinë të ndjekë një drejtim specifik, me natyrë praktike dhe të zhvillojë aftësitë teknike e njohuri profesionale. Pranë departamentit funksionojnë bordet e Tregut të punës që konsultojnë mbi organizimin e programeve të studimit dhe të planeve mësimore, për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Bordet e tregut të punës, të integruaram në strukturat e institucionit, kontribuojnë në praktikat e studentëve, dhe bëhen pjesë e auditoreve në formën e profesionistëve të ftuar. [ref: Minutat e Vizitës; Mendimi i Dekanit; Bordi i Tregut të Punës; Lista e subjekteve bashkëpunuese për programin dhe praktikat profesionale]			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Bazuar në RVB dhe nga njohja me infrastrukturën e institucionit, në mbështetje të realizimit edhe të programeve të ciklit të dytë, rezulton se ndonëse programi MSH Studime Religjose, për natyrën e profileve të tij, nuk ka të përfshira realizim të orëve laboratorike; sidoqoftë, institucioni disponon personel përkatës për mirëmbajtjen e mjediseve mësimore e të infrastrukturës në dispozicion të programit. [ref: Minutat e Vizitës; RVB]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh	Nga biseda me përgjegjësen e departamentit dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se, në nivel departamenti, organizohen Bordet e Tregut të punës, me drejtues, administrator sipërmarrjesh private apo institucionesh publike,

propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	etj. Përpara fillimit të çdo viti akademik, Bordet konsultojnë programet e studimit dhe planet mësimore, për të garantuar përputhjen e tyre me kërkesat e tregut të punës. Bordet angazhohen edhe për mbarëvajtjen e praktikave profesionale e veprimtarive të tjera që lidhen me aksesin në tregun e punës. Programi i ofruar është në përputhje me rekomandimet e shprehura nga Bordi i Tregut të Punës, por edhe strategjinë e zhvillimit të programeve në UET. Në tërësi, për organizimin e programeve të studimit dhe të planeve mësimore, UET konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve përkatëse, të organizuar në formën e Bordeve të Tregut të Punës në nivel Departamenti, për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Dekani i fakultetit ka përgjegjësi për mbajtjen e marrëdhënieve me Bordet e Tregut të Punës dhe për tërheqjen e kontributeve të tyre. Bordet e tregut të punës, që janë integruar tashmë në strukturat e institucionit, kanë kontribuar në praktikën e studentëve, duke u bërë pjesë e auditoreve në formën e profesionistëve të ftuar, si dhe kanë kontribuar me përvojën e tyre për modelimin e sylabuseve dhe programeve, në përshtatje me nevojat e tregut. Në mbledhjet e rregullta që zhvillohen me Bordin e Tregut të Punës, është argumentuar nevoja për specialistë me formim të profilizuar në fusha të tilla si edhe religjioni, filozofia, historia pranë organizatave joqeveritare dhe të shoqërisë civile, ashtu sikurse edhe në administratën publike dhe në mjedisin akademik e shkencor të vendit, edhe pse këto nuk konsiderohen si degë të tregut. [ref: Mendimi i Dekanit; Statuti UET; Bordi i Tregut të Punës]
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Bazuar në takimin me përgjegjësen e departamentit, studentët e diplomuar dhe nga RVB, rezulton se në statutin e UET është përcaktuar që, në nivel njësie kryesore, vepron si strukturë Këshilli studentor, “që promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UET”. Studentët shprehin mendime dhe propozime për të gjitha ceshtjet me interes të institucionit, si planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, cilësinë e shërbimeve dhe zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike e sportive. Institucioni i mbështet në logjistikë dhe mund të financojë projekte të tyre. Studentët përfaqësohen në Senatin Akademik, KSBC, Këshillin e Etikës. Studentët, sipas programit, marrin pjesë në mbledhjet e hapura



	një herë në muaj të Departamentit, ku u jepet mundësia të bëjnë diskutime e sugjerime në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Ndër anëtarët e Bordit të Punës ka ish studente, anëtarë nga UET Alumni, me ecure të spikatur profesionale, që kontribuojnë brenda veprimtarisë së kësaj strukture. [ref: Minutat e Vizitës; RVB; Bordi i Tregut të Punës]		
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Bazuar në statutin e UET, si edhe nga biseda me studentë të diplomuar, rezulton se institucioni, duke konsideruar si parim që studenti “të ketë hapësirën maksimale për t’u bërë aktor i formimit të vet profesional”, përcakton si prioritet në marrëdhënie me studentët, organizimin, mbështetjen dhe fuqizimin e rrjeteve ALUMNI që funksionojnë pranë tij. Qëllimi është përfshirja e tyre në strukturat konsultuese e drejtuese të institucionit, si dhe angazhimi i tyre në aktivitete apo projekte zhvilluese të tij. Studentët e diplomuar japin mendime pranë drejtuesve të dekanatit dhe departamentit lidhur me problematika e përmirësim të programit. [ref: Minutat e Vizitës; Statuti UET]		
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në fushë specifike studimi e kërkimi	Nga biseda me dekanen e përgjegjësen e departamentit ku ofrohet programi i studimit MSH në Studime Religjose, GJVJ konstaton se hapja e programit u realizua si një nismë për të zgjeruar profilin e institucionit, për t’u siguruar studentëve mundësi për njohuri të specializuara e të thelluara në fushën e studimit të religjoneve, aftësi dhe kompetenca profesionale për të dalë në tregun e punës, për implementimin e njohurive e zhvillimin e ekspertizës së fushës në institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, në organizatat joqeveritare dhe institucionet fetare, por edhe mundësinë për të zhvilluar një karrierë akademike duke vazhduar studimet e doktoratës. [ref: Mendimi i dekanit; Analiza e departamentit]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe	Nga shqyrtimi i dokumentacionit që lidhet me programin e studimit MSH në Studime Religjose, rezulton se ai “mbështetet në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe

kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” si dhe në Statutin dhe Rregulloren Mësimore të Universitetit European të Tiranës”. Rregullorja mësimore e programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat, planin dhe e veprimtaritë mësimore të tij, bazuar në objektivat madhorë të institucionit, statutit, rregullores e synimeve të tij strategjike. Programi i ofruar është në përputhje me rekomandimet e shprehura nga Bordi i Tregut të Punës, por edhe strategjinë e zhvillimit të programeve në UET. Si dhe programet e tjera të studimit në UET, nëpërmjet këtij programi studenti ka mundësinë “të ndjekë një drejtim specifik me natyrë praktike dhe të zhvillojë aftësitë teknike e njohuri profesionale”. [ref: Rregullore MSH Studime Religjoze; VKM Nr.41, datë 24.01.2018 Elementët e programeve të studimit; Mendimi i Dekanit; Statuti i UET; Rregullore UET]
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit e RVB, rezulton se njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, i përbërë nga tre departamente, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies e ato kërkimore të departamenteve përkatëse. Nga ana e tij, departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, si njësi bazë, nxit, programon, bashkërendon, zhvillon e organizon, në nivelin përkatës, punën akademike e kërkimore. Zbatimi i rregulloreve të programeve të studimit që mbulon departamenti përmban respektimin e lirisë akademike, si dhe të drejtave dhe detyrimeve e stafit akademik dhe të studentëve. [ref: Rregullore MSH Studime Religjoze; RVB; Rregullore UET]
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Nga takimi me përgjegjësen e departamentit, stafin mësimor dhe studentët e diplomuar të programit MSH në Studime Religjoze, rezulton se programi, i cili ofron njohuri të thelluara dhe të specializuara në fushën e studimeve të religjionit si dhe u përgjigjet çështjeve aktuale të dialogut ndërfetar e çështjeve të sigurisë, nxit studentët për të realizuar punime, në formën e detyrave të kursit, që i referohen aktualitetit dhe problematikave të kohës. Temat e diplomës kanë patur në fokus çështjen e ekstremizmit të dhunshëm tek fëmijët, të analizës së religjionit si instrument paqeje në kontekstin e bashkëjetesës fetare e të sigurisë në vend, tema historike mbi persekutimin e klerit

	shqiptar gjatë periudhës së diktaturës, etj. Studentët aktivizohen edhe në projektet kërkimore të pedagogëve si dhe janë pjestarë në konferencat e aktivitetet shkencore në rang institucioni e departamenti. [ref: Minutat e Vizitës; Kalendari i aktiviteteve; RVB]			
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Nga biseda me përgjegjësen e departamentit e shqyrtimin e dokumentacionit përkatës, rezulton se Departamenti, me anë të programit të studimit që ofron, “mbështet misionin e UET e të qënit lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, qendër ekselence në formimin akademik të studentëve të regjistruar në të, qendër ekspertize e specializuar në fushën e studimeve të religjionit dhe fushave të tjera ku ajo gjen zbatim, qendër ekselence për kërkimin shkencor në këto fusha”. Hapësira për studime në fushën e religjionit në Shqipëri është sa e rëndësishme aq edhe në nevojë dhe ky program studimi mund të shërbejë për të stimuluar projekte e studime kombëtare e rajonale, qoftë se kjo përputhet me synimet strategjike të institucionit, ashtu edhe për mundësitë e potencialin njerëzor e financiar. [ref: Minutat e Vizitës; Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020; Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH Studime Religjoze]			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Bazuar në RVB, me një buxhet financiar prej 75.000 euro në vit, UET financon kërkimin shkencor, duke i inkurajuar e mbështetur akademikët në aktivitete studimore, kërkimore e shkencore. Stimulimi i tyre me grante për punën kërkimore, bazohet në performancën e rezultatet e punës së tyre, publikimet dhe hulumtimet shkencore. Duke realizuar një përdorim të mirë të burimeve financiare për këtë qëllim, institucioni inkurajon anëtarët më aktivë e krijues të stafit, por edhe ushqen një mjedis, ku “kërkimi është pjesë integrale e jetës universitare”. [ref: RVB]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	0% (e pambylloret)	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Nga biseda me dekanen dhe përgjegjësen e njësisë bazë, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezultojnë se institucioni ka bërë planifikimin strategjik me projekte që realizojnë në praktikë objektivat strategjike të fushes kërkimore. Planet e Integruara të Kërkimit Shkencor detajohen me afate kohore, me detyra konkrete për njësitë kryesore e grupet kërkimore si edhe ato administrative dhe mbështetëse. Indikatorët e Performancës së Kërkimit Shkencor zhvillohen për ndjekjen e realizimit të synimeve të institucionit, duke shërbyer edhe për ballafaqimin me rezultatet e pritshme që lidhen me objektivat bazë të Strategjisë, madje, në bazë të indikatorëve, çdo dy vjet në UET zhvillohet folloë up me stafin akademik mbi publikimet dhe aktivitetin e tyre shkencor. Si njësi të rëndësishme të veprimtarisë kërkimore, Qendrat Kërkimore-Shkencore asistojnë në veprimtarinë kërkimore të njësisë bazë si dhe organizojnë trainimet metodologjike të stafit akademik në bashkëpunim me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Projektet e Mëdha Kërkimore përbëjnë shtyllën e kërkimit shkencor në UET, me synim ndër-disiplinaritetin e kërkimit. Ato janë instrumenti kryesor i drejtimit dhe gjenerimit të punimeve dhe botimeve shkencore dhe realizojnë koordinimin e kërkimit shkencor si dhe përdorimin e tij për palët e treta të interesuara në aplikimin e produktit shkencor. [ref: Minutat e Vizitës; Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020]
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Bazuar në dokumentacionin përkatës, rezultojnë se, në vizionin e UET, kërkimi shkencor është në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore. Pjesa më e madhe e personelit të brendshëm është e angazhuar në kërkim shkencor dhe drejton grupe kërkimore, ndërsa janë përfshirë në këto procese në nivel grupi edhe studentët të programit MSH, krahas doktorantëve, të cilët atashohen pranë një grupi kërkimor për zhvillimin e punimit të tyre daktoral. [ref: Plani strategjik për zhvillimin e programit MSH në Studime Religjioze; Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020]
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit përkatës, rezultojnë se njësia përgjegjëse, departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit është e përfshirë në konferenca e aktivitete

ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	shkencore që ndihmojnë për realizimin e objektivave të kërkimit shkencor. Staf akademik i njësive përgjegjëse ka një background të konsoliduar në fushën kërkimore-shkencore. Konferenca vjetore “Ditët e Studimeve Shqiptare”, në panelet e saj të veçanta, zhvillon tematika brenda fushës së mësimdhënies e asaj kërkimore-shkencore të njësive përgjegjëse. <i>Sidoqoftë, ndoshta për kohën e shkurtër të funksionimit të programit si dhe kushtet e pandemisë (2018-2020) nuk pati veprimtari kërkimore e aktivitete shkencore që lidheshin drejtpërsëdrejti me fushën specifike të programit.</i> [ref: Ditët e Studimeve Shqiptare; Kalendari i aktiviteteve]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	Në Planin Strategjik të UET 2015-2020 është përcaktuar si prioritet i procesit mësimor “rritja e vazhdueshme e cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe duke nxitur të qenin proaktiv e kritik në dhënien e opinioneve mbi çështje aktuale”. Nga njohja me dokumentacionin përkatës, bazuar në RVB por edhe nga biseda me Dekanen e përgjegjësen e departamentit, rezulton se UET ka përgatitur e shpërndarë pranë njësive bazë udhëzues e materiale orientuese për zhvillimin e përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies, në përputhje me fushat përkatëse të studimeve, sipas parametrave bashkëkohore. Në praktikën e institucionit ka tashmë përvojë në organizimin e trainimeve të personelit akademik për kualifikim të mëtijshëm në metodat e mësimdhënies, por edhe impakt në këtë drejtim nga trainimet që lidhen me publikimet shkencore si dhe veprimtaritë kërkimore-shkencore. [ref: Minutat e Vizitës; Plani strategjik 2015-2020]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Bazuar në RVB, dokumentacionin përkatës, bisedat me përgjegjësen e departamentit dhe përfaqësues të KSBC, përfaqësuesin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, rezulton se në UET funksionojnë mekanizma monitorimi dhe vlerësimi periodik të aftësive dhe progresit në procesin mësimdhënës të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, aplikohen: format e vetëvlerësimit, të vlerësimit nga studentët, të vlerësimit të mësimdhënies në auditor për lektor e asistent lektor nga Dekani, përgjegjësi i njësisë bazë apo përgjegjësit e grup-lëndëve. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu është i zbërthyer në indikatorë të detajuar, që mundësojnë një proces vlerësimi për një sërë komponentë të përmbajtjes e organizimit të mësimin, të pedagogjisë e komunikimit me studentët etj. Në planin vjetor të veprimit të KSBC përfshihet kontrollë periodike të syllabuseve, përpunimi i të dhënave të pyetësorit online të studentëve, të pyetësorit me fokus-grup, etj [ref: Minutat e Vizitës;



	Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu; Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi syllabuset; Plani i veprimit KSBC]
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Nga takimi i GVJ me studentë të programit të studimit, përfaqësues të KSBC, përfaqësues të Zyrës së Kujdesit për Studentin, raporti i GVB, rezulton se institucioni garanton rolin e studentëve në procesin e vlerësimit periodik të metodave të mësimdhënies, të tërheqjes së mendimit të tyre mbi programet studimore e modulet e lëndëve, mbi cilësinë e aksesin e literaturës, mbi etikën e komunikimit të pedagogëve. Format e aplikuara për këtë qëllim janë pyetsorët e formularët e administruar nga KSBC që analizon, nëpërmjet tyre, “problematikat e ndeshura në procese kyçe të veprimtarisë mësimore – kërkimore (të tilla si: shpërndarja e ngarkesës mësimore në nivel departamenti, kualifikimi i personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, cilësia e mësimdhënies dhe çështje të vlerësimit të studentëve, etj.), dhe harton raportet me gjetjet përkatëse”. Forma të tjera janë takimet periodike me studentët në formën e “fokus-grupeve”, pjesmarrja e tyre në mbledhjet e hapura të Departamentit, ndërsa Zyra e Kujdesit ndaj Studentit dokumenton rastet e ankimeve të cilat, për problematika të përcaktuara, sic parashikon edhe rregullorja e UET, i drejtohen për shqyrtim përgjegjësit të departamentit. Ka një procedurë që zbatohet në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi ka marrë shpjegimet përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Sipas rregullores “ai mund t’i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e komponentit përkatës...Përgjegjësi i Departamentit ngrë një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar”. [ref: Minutat e Vizitës; Rregullore e UET; Dokumenti F. VII Mbi sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Dokumenti E.VII Mbi Funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës e Kujdesit ndaj Studentit; Formular për ankesat e studentëve; Format i vlerësimit të pedagogut nga studenti]
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë	Nga biseda e GVJ me Përgjegjësen e Departamentit, përfaqësues të KSBC dhe nga RVB konfirmohet se rezultatet e procesit të

në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	vlerësimit, pasi përpunohen nga KSBC si strukturë përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë apo zyra e IT kur vlerësimi është bërë online, u komunikohen autoriteteve drejtuese të institucionit dhe posaçërisht përgjegjësit të departamentit që ia bën të ditur personelit akademik: “Rezultatet e KSBC-së publikohen përmes një raporti të brendshëm që i dërgohet Rektorit dhe Administratorit të UET. Pjesët e raportit që lidhen me Fakultetet përkatëse i vihen në dispozicion edhe Dekanëve të Fakulteteve dhe Drejtuesve të Departamenteve”. Departamenti ka për detyrë të analizojë të dhënat, të verifikojë besueshmërinë e tyre dhe të marrë masa për përmirësimet e nevojshme. [ref: Minutat e Vizitës; Dokumenti F. VII Mbi sigurimin e Brendshëm të Cilësisë]
--	---

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	Sipas bisedës me dekanen e fakultetit të përgjegjësen e njësisë bazë e RVB, rezultatet pozitive të procesit të vlerësimit i shërbejnë nxitjes e inkurajimit të zbatimit të praktikave më të mira në procesin e mësimdhënies. Në mbledhjet e njësisë bazë por edhe në seminarin trainuese këto praktika shërbejnë si referenca për përmirësim të mëtejshëm të eksperiencës së mësimdhënies në institucion. [ref: Minutat e Vizitës; RVB]
--	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kurse, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës e syllabuseve të lëndëve, rezulton se institucioni e ka ndërtuar procedurën e format e mësimdhënies, mësimnxënies e transmetimit të dijeve në përputhje të plotë me rregulloren në fuqi (VKM Nr.531, datë 24.01.2018). Format e zhvillimit të procesit mësimor janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, praktikat mësimore, detyrat praktike dhe detyrat e kursit, praktikat profesionale, leksione të hapura etj. Provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare si dhe punimi i diplomës përbëjnë format e tjera vendimtare të testimit dhe vlerësimit të studentëve. Sipas analizës së Departamentit të Shkencave Humane dhe

	Komunikimit (që ofron programin MSH në Studime Religjoze) mbi arritjen e objektivave formues të programit të studimit, vihet në dukje se “ngarkesa e çdo programi të studimit është strukturuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi....Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës dhe aftësimit profesional. Struktura e programeve, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara sipas programeve”. [ref: Plani mësimor i MSH në Studime Religjoze; Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese në MSH në Studime Religjoze; Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës; Analiza e Departamentit]
Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Sipas bisedës me përgjegjësen e njësisë bazë, stafin akademik të angazhuar në programin e studimit dhe studentë të programit, evidentohet se personeli bën përpjekje t’u përgjigjet nevojave dhe diversitetit të studentëve si dhe sugjerimeve të tyre lidhur me programin e mësimdhënien. Vetë studentët vijnë nga mjedise shoqërore e kultura fetare të ndryshme si dhe nga eksperiencia pune të caktuara dhe stafi mësimor ka ushtruar në mënyrë profesionale detyrimin që me forma, metoda, aktivitete formuese e mundësi alternative mësimdhënieje t’u përgjigjet interesave e këndvështrimeve si dhe pritshmërive të auditorit. [ref: Minutat e Vizitës, Kurrikula e programit MSH Studime Religjoze]
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme	Institucioni realizon forma të ndryshme në mbështetje të personelit akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike e përdorimin e metodave të reja pedagogjike. Pedagogët trainohen në mënyrë periodike, në përputhje me kualifikimin e tyre pedagogjik e shkencor. Kalendari i aktiviteteve të institucionit, me larmishmërinë e tij, ka impakt edhe në forcimin

të të nxënësit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	e cilësisë e performancës në procesin e mësimdhënies, ndërsa “Dita e Zhvillimit të Stafit” është një aktivitet i institucionit me synime të drejtpërdrejta trainuese lidhur me mësimdhënien, metodologjinë, projektet e kërkimit shkencor. Gjithashtu, programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perendimore e projektet e përbashkëta i shërbejnë shkëmbimit të eksperiencës dhe njohjeve të reja në fushën e metodologjisë e kompetencave didaktike. [ref: minutat e vizitës, Kalendari i aktiviteteve; Të dhëna mbi projektet e shkëmbimit të stafit]
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Nga biseda e GVJ me stafin akademik e studente të programit si edhe nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik dhe angazhimit të tyre përkatës në lëndët e programit të studimit, rezulton se titullarët e lëndëve kanë një background të pasur akademik dhe shkencor në fushat e tyre të studimit dhe mësimdhënies, eksperiencë profesionale në metodologjitë e didaktikën mësimore. <i>Sidoqoftë, GVJ ka konstatuar se, në disa raste, titullarë lëndësh kanë paraqitur për programin specifik të studimit MSH në Studime Religjose të njëjtat sylabuse lëndësh të zhvilluara në programe e profile të tjera studimi.</i> [ref: CV e stafit; Syllabuset e lëndëve]
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga takimi me përgjegjësen e departamentit, stafin akademik dhe grupin e studentëve të programit, rezulton kujdesi e përpjekja nga ana e institucionit për të përmirësuar format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë edhe mendimet e sugjerimet e studentëve. [ref: Minutat e Vizitës]
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Nga biseda me stafin akademik dhe studentë të programit, evidentohet përpjekja për të përdorur metoda interaktive dhe diskutimi që i bëjnë interesante e efektive orët e mësimi. Programi MSH në Studime Religjose është i lidhur me analizën e një realiteti dinamik të kulturave fetare e rolit të tyre në zhvillimin historik të shoqërisë e qytetërimeve si dhe me një impakt të drejtpërdrejtë në realitetin shqiptar, cka sjell interes e një mjedis interaktiv diskutimi. [ref: Minutat e Vizitës; Kurrikula e programit MSH Studime Religjose]
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe	Stafi i programit MSH në Studime Religjose ka përgjithësisht një eksperiencë të gjatë mësimdhënieje e metodologjike, kërkimore e shkencore. Nga takimi me studentë të programit, pohohet përpjekja nga ana e stafit për të inkurajuar tek studentët

ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	sensin e autonomisë e diskutimin e lirë, marrëdhënie bashkëpunimi frytdhënëse e komunikim etik. [ref: Minutat e Vizitës]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Nga takimet e vizita në institucion, GVJ konfirmon se institucioni ka siguruar hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të pastra e të mirëmbajtura për zhvillimin e procesit mësimor e shkencor. Infrastruktura në UET u përgjigjet kërkesave e standarteve të cilësisë. Sallat e leksionit, në formë amfiteatri dhe të pajisura me sistem fonie, zenë një hapësirë të konsiderueshme (10 salla kanë sip. 1510 m ² me 1,515 vende dhe 9 janë me sip. 900 m ² dhe 630 vende). Ka 14 klasa për seminare (gjithsej 630 m ² me 490 vende), salla për veprimtari promovuese, salla për praktikë lëndore/profesionale, laboratorë për lëndët dhe informatike, etj. [ref: Minutat e Vizitës; Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit]
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Nga takimet e vizita në institucion, GVJ konfirmon se mjediset që i dedikohen procesit mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme. Sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 10 salla me sipërfaqe totale 1510 m ² dhe 1515 vende; salla seminari janë gjithsej 14, me sipërfaqe 45 m ² dhe secila me nga 35 karrige; salla 70 vendëshe (leksione + seminare) janë gjithsej 9, me sipërfaqe 100 m ² secila; salla për departamentet janë gjithsej 8 ambjente me sipërfaqe 45m ² secila. Gjithashtu, institucioni disponon zyra për përgjegjës departamenti, gjithsej 10 ambjente me nga 18 m ² , zyra për koordinatorë, gjithsej 6 ambjente me nga 14m ² , 3 zyra për sekretarinë mësimore me sipërfaqe 140 m ² . Në funksion të procesit mësimor janë gjithashtu: 3 salla për laborator informatike me sipërfaqe 45 m ² , secila e kapacitet 35 vende, sallë interneti me sipërfaqe 165 m ² me 80 kompjutera, salla e

	bibliotekës me sipërfaqe 300 m² dhe 150 vende leximi. Mjedisi për fotokopje dhe librari ka sipërfaqe 150 m². Ka zyra informacioni për studentët, mjedise çlodhës për kafe/fastfood/etj., Nyjet hidrosanitare, gjithsej 48, zenë një sipërfaqe 300 m². Sallat për leksionet dhe seminarët janë të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni. [ref: Minutat e Vizitës; Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit]
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Nga vizita në institucion e dokumentacioni përkatës, rezulton se institucioni ka marrë masa për aksesimin nga ana e personelit akademik dhe studentëve të infrastrukturës IT e sistemeve të ndryshme informatike. “Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softëare-t përkatës në mënyrë që t’i shërbejnë sa më mirë programit mësimor; sistemet e operimit janë të gjithë Ëindoës 10, MS TEAMS; paketa Microsoft Office 365 është instaluar e plotë me të gjithë softëare-t e saj: Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PoëerPoint; Publisher; SharePoint Ëorkspace, Ëord, Navicat for my SQL; NetBeans; JetBrain; Apache Tom Cat; UCINET; CAD, etj. Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal ËiFi, në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht ëeb-in. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor”. Duke ndjekur zhvillimet e reja teknologjike, UET ka investuar në sisteme, të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor. Programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike në UET bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit. [ref: Minutat e Vizitës; Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit]
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.	Nga vizita në institucion, takimi me studentët e diplomuar e dokumentacioni përkatës, rezulton se literatura bazë dhe ajo e rekomanduar (fizike dhe digjitale) është e aksesueshme për studentët, në shqip edhe anglisht, për të garantuar marrjen e dijeve dhe informacionit të nevojshëm. Fondi i Bibliotekës për programin MSH Studime Religjioze përmban në total 116 tituj, nga të cilat, në gjuhën shqipe janë 104 tituj dhe në gjuhë të huaja 10 tituj. Përsa u përket periodikëve, në total janë 7 tituj në gjuhën shqipe. Ndërkaq, libra në format PDF (e-book) janë 74 tituj dhe

	periodikë në format PDF (e-book) 27. Bibloteka furnizohet me libra e botime periodike. Në mbështetje të programit, përgjegjësit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të biblotekës. Gjithashtu, Bibloteka është e abonuar në Sage&EBSCO, Questia, ASTM Compass, Edëard Elgar Publishing – Elgar Online Platform, për periudha 5 vjecare ose pa limit. Ajo është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). [ref: Minutat e Vizitës; Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB; Dokumenti E.IV Mbi funksionimin e Biblotekës]
Kriteri 5. Bibloteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Nga vizita në Biblotekën e institucionit e biseda me punonjëset e saj si dhe bazuar në dokumentacionin përkatës, rezulton se bibloteka disponon një numër botimesh të viteve të fundit për drejtimet kryesore të programit, që janë në pasurim e sipër me tituj të rinj. Bibloteka ka hapësirë të konsiderueshme për të krijuar komoditet në përdorimin nga studentët me një sipërfaqe prej 300 m² dhe 150 vende leximi. [ref: Minutat e Vizitës; Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB; Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit MSH Studime Religjoze]
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Nga informacioni në vizitat në institucion e dokumentacioni përkatës, rezulton se Bibloteka është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage & Ebsco si edhe Questia. Bibloteka ka krijuar një Katalog me libra elektronike në gjuhë të huaj i cili ka qindra tituj librash në bazë të programeve të studimit duke u ardhur në ndihmë studentëve në bazë të interesave të tyre akademike. Në biblotekë janë instaluar 14 PC, nëpërmjet të cilave studentët aksesojnë biblotekat on-line. Për t'u ardhur sa më mirë në ndihmë studentëve dhe pedagogëve, Bibloteka ofron shërbimet on-line për kërkim në sistemet e biblotekave elektronike. [ref: Minutat e Vizitës; Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB; Dokumenti E.IV Mbi funksionimin e Biblotekës]
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Nga vizita në institucion e biseda me studentët, konstatohet se studentët shfrytëzojnë në mënyrë të vazhdueshme infrastrukturën e nevojshme për realizimin e detyrave të kursit, punimeve të diplomës apo punëve të tjera kërkimore; mjediset përkatëse janë të pajisura me PC dhe projektorë, ndërsa laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme, sipas fushës studimore. Mjediset e biblotekës apo sallës së internetit shfrytëzohen gjithashtu në mënyrë efektive nga studentët.

	[ref: Minutat e Vizitës; RVB]
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Nga vizita në institucion e biseda me personelin akademik e studentët, konstatohet se, në funksion të mësimdhënies, shfrytëzohet platforma on-line. Me urdhër të posaçëm administrative (02.11.2017) është vënë në efikasitet të plotë platforma UET LMS (sistemi i menaxhimit online të mësimdhënies) me të gjitha funksionet e veta (ngarkim të literaturës, njoftime të pedagogut, pikët individuale të vlerësimit për studentin, dërgimi i detyrave apo eseve, etj). Platformat online të mësimdhënies (e-learning) UET LMS dhe Microsoft Teams funksionuan në mënyrë efikente edhe gjatë periudhës së pandemisë. Zyra e IT në UET ka kryer trainime për përdorimin e këtyre platformave online të mësimdhënies. [ref: Minutat e Vizitës; Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS; Video-trainime mbi sistemin TEAMS-LMS]
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Bazuar në takimin me stafin akademik dhe studentët si dhe në RVB, konstatohet se sistemet e komunikimit të brendshëm janë efektive për personelin akademik e studentët për akses në dokumentacionin elektronik. “Me sistemin MOODLE (UET LMS), bëhet e mundur që studenti, në kohë reale, të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksionet, materialet shtesë audio visive, duke patur mundësinë të komunikojë nëpërmjet sistemit edhe në forume të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit, të shikojë notat dhe pikët on-line”. [ref: Minutat e Vizitës; RVB]
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Nga biseda e GVJ me përgjegjësen e Departamentit, stafin akademik dhe studentët të programit, si dhe nga njohja në sekretarinë mësimore me tematikën e diplomave të studentëve që kanë përfunduar programin, rezulton se udhëheqja e temave është bërë në përputhje me orientimin nga ana e personelit akademik dhe sipas interesit të studentëve, në përshtatje me profilin përkatës. Sipas rregullores përkatëse, lidhur me procedurën e realizimit të diplomës, anëtarët e personelit akademik, në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës, rekomandojnë tema diplome sipas profilit të fushës së studimit. Studentët pajisen nga departamenti, “me formularin e aplikimit për temën e diplomës, shoqëruar me listën e pedagogëve të mundshëm udhëheqës dhe me inventarin e temave të propozuara. Studenti plotëson formularin e aplikimit në konsultim paraprak me një pedagog dhe e dorëzon atë brenda afatit të shpallur”. Seancat metodologjike të aplikuara si orë seminaresh, kanë për qëllim të ndihmojnë

	studentët të përpunojnë aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës. Në to trajtohen çështje që lidhen me përcaktimin shkencor të objektit të studimit, diskutimin e dobisë së punimit, caktimin e problematikës që do të trajtohet, ndërtimin e hipotezave, trajtimin e aspekteve metodologjike, të strukturës, të burimeve parësore dhe dytësore ku do të mbështetet punimi. Në rastin e një punimi diplome të nivelit MSH, kërkesat dhe karakteristikat i përgjigjen këtij niveli e lidhen me llojin temës së zgjedhur, të metodologjisë së përdorur, të numrit të burimeve, të kohëzgjatjes së punës në terren, etj. Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, GJV pa temat e mbrojtura nga studentët e diplomuar të këtij program studimi. GJV konstatoi se temat ishin aktuale dhe në përputhje me programin e studimit. [ref: Minutat e Vizitës; Dok.B.II Mbi punimin e diplomës]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Nga takimi me dekanen dhe përgjegjësen e njësisë bazë, përfaqësues të KSBC dhe zyrës së kurrikulave, bazuar edhe në dokumentacionin përkatës, rezultoi se institucioni ka në përbërje të strukturës së vet organizative një njësi autonome të posaçme, siç është KSBC-së që, mbështetur në kriteret e standartet europiane të sigurimit të cilësisë për IAL, vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore e propozon ndryshime për përmirësime të mëtejshme. Kjo përcaktohet në statutin e UET, ndërsa në planin e veprimit të KSBC përcaktohen komponentët ku shtrihet aktiviteti i kësaj strukture, me format përkatëse në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme. Monitorohet përmbajtja e syllabuseve të lëndëve në përputhje me programet e profileve përkatëse, cilësia e mësimdhënies së stafit akademik të programit duke aplikuar pyetësorin online të studentëve, vlerësohet realizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në nivel departamenti por edhe niveli i përfshirjes së studentëve në punën kërkimore, niveli i përfshirjes



	së studentëve në vendimmarrje, vlerësimi i trajtimit të ankesave të studentëve, rishikimi i kurrikulave, monitorohet kualifikimi i stafit akademik etj. Për përmirësimin e cilësisë në veprimtarinë mësimore, kërkimore e shkencore por edhe administrative, njësia organizon edhe trajnime të posaçme, ndërsa në fund të vitit akademik hartohet raporti përfundimtar. I gjithë aktiviteti i KSBC realizohet në bashkëpunim me njësitë kryesore e ato bazë. [ref: Minutat e Vizitës; Statuti UET; Plani i veprimit KSBC]
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Sipas bisedës me përgjegjësen e departamentit, shqyrtimit të dokumentacionit e RVB, rezulton se departamenti është njësia bazë që përgjigjet për cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit që ofron. Ai administron dhe organizon profilet e përmbajtjen e tyre lëndore, bën përzgjedhjen e stafit akademik të programit bazuar në ekspertizën akademiko-shkencore, vlerësimin e syllabuseve e ndarjen e ngarkesës përkatëse. Departamenti ndjek në vazhdimësi performancën e anëtarëve të stafit gjatë procesit të folloë-up, duke përcaktuar edhe nevojat për trajnime dhe kualifikime profesionale, sidomos të stafit të ri. Departamenti është në kontakt të vazhdueshëm me studentët për feedback-un e tyre ndaj cilësisë së mësimdhënies në programin e studimit që ofrohet. [ref: Minutat e Vizitës; Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e departamentit; Analiza e Departamentit]
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të programit MSH në Studime Religjoze, GVJ konstaton se formati i tyre është i strukturuar të përfshijë edhe metodën pedagogjike të përdorur në mësimdhënien nga pedagogët. Përgjithësisht, si metoda të zhvillimit të seminareve për programin, aplikohet “diskutim e prezantim në grup”, “bashkëbisedime në auditor rreth temave të trajtuara në leksione”, “analiza konkrete të rasteve”, “brainstorming”, “debat dhe tërheqje e mendimit të studentëve për çështjet e trajtuara në leksion”, etj. [ref: Formatit syllabusit, cikli i parë dhe i dytë; Syllabuse të programit MSH në Studime Religjoze]
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në dokumentacionin përkatës, rezulton se UET ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione homologe brenda dhe jashtë vendit; në strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional janë përfshirë edhe programet e studimit në Departamentin e Shkencave Humane dhe Komunikim. Trajnimet e personelit akademik për çështje didaktike dhe të metodave kanë qenë sistematike; për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies e

	te përdorimit të metodave të reja, janë shfrytëzuar periudhat e shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve Erasmus+ KA1. [ref: Raporti periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit]
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Nga biseda me përgjegjësen e departamentit e dokumentacionin përkatës, evidentohet se Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, në funksion të arritjes së objektivave strategjike, vlerëson si prioritet “mbështetjen e stafit akademik të programit të studimit, në kuadër të trajnimit të vazhdueshëm të tyre me qëllim përmirësimin e cilësisë”. Si prioritet, ai synohet të arrihet në bashkëpunim me njësi të caktuara e të specializuara të institucionit, si Zyrën e Projekteve, Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyrën e IT, Zyrën e Standardeve dhe Cilësisë, Komisionin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, Drejtorinë e Zhvillimit të Kurrikulave etj, bazuar në trainime mbi standardet shtetërore të cilësisë për programet e studimit, hartimin dhe përditësimin e planeve lëndore dhe kurrikulave të programit të studimit, përdorimin e platformave online të mësimdhënies etj. Në planin strategjik, për trainimin e vazhdueshëm të stafit akademik, parashikohen shkëmbime stafi me institucione të arsimit të lartë dhe institucione kërkimore-shkencore partnere, vendase dhe të huaja. Stafi akademik i angazhuar në këtë program ka kryer trainime e mësimdhënie në kuadër të projektit Erasmus+ KA1. <i>Sidoqoftë, GVJ konstaton se këto trainime nuk kanë patur në fokus, në mënyrë të posaçme, fushat specifike të programit të ri.</i> [ref: Minutat e Vizitës; Plani strategjik për zhvillimin e programit MSH në Studime Religjose; Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit]
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Bazuar në takimin me stafin akademik të programit dhe RVB, konstatohet se përmirësimi dhe përdorimi i metodave të reja të mësimdhënies është detyrë në vazhdimësi e stafit akademik e ndihmës akademik, si testim edhe për ecurinë e performancës së tyre akademike. Në mënyrë të detyruar, syllabuset rishikohen çdo vit dhe kjo krijon mundësinë e hapësirën për përmirësime e reflektime, duke ballafaquar rezultatet dhe efektivitetin e metodologjive të përdorura. [ref: Minutat e Vizitës; RVB]
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për	Bazuar në takimet me stafin akademik të programit dhe RVB, konstatohet se personeli akademik, në kuadër të lirisë akademike e përvojës në mësimdhënie, në përshtatje edhe me profilin e programit, përdor metoda të reja të mësimdhënies e

rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	mësimnxënies, që bëhen objekt diskutimi edhe në department, mes kolegësh si shkëmbim përvoja. [ref: Minutat e Vizitës; RVB]		
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit e RVB, UET ka krijuar një praktikë disa vjeçare bashkëpunimi me universitete partnere në përfshirjen e lektorëve e kërkuesve shkencorë në veprimtaritë akademike e shkëmbimin e përvojës. Janë organizuar edhe aktivitete të posaçme me ekspertë të fushave për shkëmbim të ideve mbi metodat e msimdhënies e kërkimit shkencor, si “Hoë to publish and Research” (Qershor 2017), “UET Research (Gusht 2018) etj. Lidhur me programin MSH në “Studime Religjoze”, “nuk ka patur staf akademik nga vendet partnere të BE për mësimdhënie në këtë program studimor” ndërsa lektorë vendas, ekspertë të fushës janë ftuar për ligjërime në “cëshitet e sigurisë”. [ref: RVB; Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në përputhje me rregulloren e UET, për programin e studimit MSH në “Studime Religjoze”, ekziston rregullorja e posaçme e hartuar sipas objektivave të programit përkatës të studimit, me planin mësimor dhe me veprimtaritë mësimore të tij. Në të paraqiten, ndër të tjerash, edhe kriteret e mënyra e testimit të dijeve, ku vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në “parimin e kontrollit të vazhdueshëm”. Përcaktohen elementët e këtij kontrolli dhe pesha e tyre në vlerësimin përfundimtar: provimi i ndërmjetëm (30%), niveli i diskutimit (10%), detyra e kursit (ese, prezantime, projekte) (20%), provimi përfundimtar (40%) si edhe rastet e riprovimeve, bartjes, rivlerësimit etj. Rregullorja bëhet e njohur për studentët: “Rregullorja dhe programi i studimit publikohen në fillim të çdo viti akademik. Pas kësaj, studenti konsiderohet përgjegjës për njohjen dhe respektimin e detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga kjo rregullore”. [ref: Rregullore UET; Rregullore MSH në “Studime Religjoze”]

Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi me stafin akademik të programit dhe studentët e diplomuar, bazuar tek RVB, GVJ konstaton se institucioni ka si praktikë pune që, në fillim të procesit mësimor, çdo titullar i lëndës t'i informojë studentët mbi syllabusin përkatës të lëndës, metodologjinë e testimit, format e vlerësimit të njohurive, afatet e plotësimit të detyrimeve, etj. [ref: Minutat e Vizitës; RVB; Rregullore MSH në “Studime Religjoze”]			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Rregullorja e institucionit, që përcakton mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive të studentit, parashikon forma të ndryshme, sipas kriterit të “kontrollit të vazhdueshëm”. Elemente kryesore të tij janë provimet, detyrat e kursit apo detyrat praktike, aktivizimi në seminare. Në këtë mënyrë, duke e ndarë vlerësimin në disa komponentë, synohet objektiviteti dhe efektiviteti më i mirë i testimit. Përsa i përket tezës së provimit, si mënyrë vlerësimi e njohurive dhe aftësive argumentuese të studentëve, ajo hartohet me 3 kategori pyetjesh, si: pyetje që kontrollojnë njohuritë (20 - 30% e tezës), pyetje që testojnë aftësitë analitike (40 - 50% e tezës), pyetje që kërkojnë mendimin dhe qëndrimin individual të studentit (20 – 30 % e tezës). Në varësi edhe të natyrës së lëndës, pedagogu përshtat format e ndryshme të kontrollit për vlerësimin e dijeve të nxëna, për t'i dhënë mundësi edhe studentit t'i demonstrojë më mirë ato. Përgjithësisht, me këto forma kontrolli, synohet të inkurajohet studenti për të mësuar sistematikisht, duke e konsideruar vlerësimin si nxitës e jo penalizues. Vlerësimi i studentit, si rregull, shoqërohet me shpjegimin përkatës. [ref: Minutat e Vizitës; Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimi të studentit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Bazuar në Rregulloren Mësimore të Programit të studimit MSH “Studime Religjoze” pika 5.2-5.8.2 reflekton procedurën e testimit të vazhdueshëm përgjatë gjithë semestrit të dijeve dhe aftësive të studentëve. Sikundër është trajtuar dhe tek dokumenti “.A.IV Sistemi i Vlerësimit të Studentëve” përcaktohet se: “Vlerësimi i

	studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë. a. Nxiti studentin që të mësojë gjatë gjithë vitit; b. Prodhon një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim; c. Shërben për të vlerësuar ecurinë e kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs”. Ky proces realizohet në disa komponent dhe me përqindje të saktësuara të sistemit të vlerësimit dhe reflektohet dhe tek vlerësimi përfundimtar si: a. Provimi i ndërmjetëm (30%) b. Niveli i diskutimit (10%) c. Detyra e kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike (20%) d. Provimi përfundimtar (40%). Gjatë vizitës në institucion dhe takimit të realizuar me studentët e këtij Masteri konfirmuam procesin e vlerësimit dhe testimit të vazhdueshëm. [ref: Rregullore MSH në Studime Religjose; Minutat e Vizitës]
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni vë në dispozicion si në programet bachelor dhe master sistemin e vlerësimit elektronik “Clean Scoring”. Ky system është mundësuar nga projekt - bashkëpunimi me AADF. Përdorimi i këtij sistemi vlerësimi është në varësi të specifikave të lëndës. [ref: RVB]
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Sikundër është përcaktuar dhe në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit, testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive realizohet nga pedagogu i lëndës apo në bashkëpunim me pedagogët asistent. Komisionet e posaçme ngrihen në rastin e mbrojtjes së praktikës profesionale apo mbrojtjes së punimit të diplomës. Gjithashtu në rastet e ankimimit të vlerësimit nga ana e studentit dhe marrjes në konsiderate nga ana e strukturës drejtuese, procedura e kërkon me ngritje komisioni të përbërë nga tre anëtarë. [ref: Rregullore MSH në Studime Religjose; RVB]
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Bazuar në pikën 5.3.2 të Rregullores Mësimore të programit të studimit: “Provimet zhvillohen me procedurë sekretim duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore”. Pra procesi i testimit, vlerësimit të njohurive dhe dijeve me shkrim realizohet në mënyrë anonime. Për mbarvajtjen e procesit, provimet zhvillohen me dy pedagogë në auditor. [ref: Rregullore MSH në Studime Religjose; RVB]
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e	Në pikën 5.3.4 të Rregullores Mësimore të programit të studimit përcaktohet se: “... seancat sqaruese, ku pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin”. Gjithashtu dhe gjatë takimit me studentët e këtij program master na u sqarua procedura e vlerësimit

të nxënësit për të ndihmuar studentin të përnirësohet në të ardhmen.	dhe sqarimi që bënte stafi akademik mbi vlerësimin e realizuar. [ref: Rregullore MSH në Studime Religjoze; Minutat e Vizitës]
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Institucioni dhe strukturat përgjegjëse marrin disa masa për evitimin e kopjimit dhe përdorimin e plagjiaturës në realizimin e detyrave të kursit apo punimit të diplomave. Më konkretisht këto masa saktësohen në evidencen 7.1, “A.IV Sistemi i Vlerësimit të Studentëve” pika A.IV.2.6 dhe A.IV.2.7. Këto masa lidhen me mënyrën sesi zhvillohet provimi duke patur dy ose dhe më shumë personel akademik me funksion mbikqyrës, njoftimin e studentëve për rregullat e sjelljes dhe të komunikimit në sallën e provimit, me moslejimin e përdorimit të mjeteve të komunikimit si dhe në rast të konstatimit të kopjimit masa ndëshkimore është e lartë. Gjithashtu në Rregulloren e Universitetit Neni 33 pika 1, 2 dhe 3 specifikohet se çfarë quhet plagjiaturë dhe kopjim dhe cilat janë pasojat ndëshkuese në rast të përdorimit të tyre nga studentët. [ref: Rregullore UET; Dok.A.IV “Sistemi i Vlerësimit të Studentëve”; RVB]
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Koha e dorëzimit të provimeve është e përcaktuar në Rregulloren e UET dhe dokumentave të tjera. Brenda dy javëve nga data e zhvillimit të provimit stafi akademik duhet të realizojë korrigjimin dhe seancat sqaruese. Në takimin me studentët e këtij programi u konfirmua fakti se procedura e kontrollit të dijeve mundëson vlerësimin objektiv të njohurive të tyre. [ref: RVB; Minuta e Vizitës]
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	E drejta për tu njohur me vlerësimin është e përcaktuar në Rregulloren e Institucionit dhe Programit të Studimit. Institucioni ka ndërtuar procedura për garantimin e kësaj të drejte si për transparencën e vlerësimit dhe për shqyrtimin e ankesave në rastet kur student nuk është i bindur për vlerësimin e marrë. Në këto raste Drejtuesi i Departamentit ngre komision me staf akademik që janë njohës të lëndës dhe realizon procedurën e rishikimit të vlerësimit duke e dokumentuar atë. [ref: Rregullore UET; RVB]
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Sikundër është përmendur dhe më lartë procedura e ankimit realizohet bazuar në nenin 32 të Rregullores së UET e cila saktëson procedurën si vijon: “...Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe

	mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar.” Procedura dokumentohet dhe arkivohet. [ref: Rregullore UET; RVB]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Masteri Shkencor “Studime Religjoze” është i pari i këtij lloji në vendin tonë. Sikundër na u sqarua në takimin me Dekanen dhe anëtarët e grupit të punës për përgatitjen e RVB-së ky master aftëson studentët në analiza të thelluara dhe të specializuara në fushën e studimeve të religjionit. Sipas tyre “Ky program u ka ofruar studentëve njohuri të specializuara dhe të thelluara të koncepteve historike, kulturore, politike dhe ideologjike të lidhura me religjionin, me qëllim përgatitjen e studentëve për t’i aplikuar këto njohuri në mjedisin intelektual dhe profesional”. [ref: Mendimi i Dekanit; Minutat e Vizitës]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Masteri Shkencor “Studime Religjoze” me 5 profile studimi fokusohet në njohuri specifike që lidhen me fushën e religjionit në një kontekst të gjërë. Literatura e shfrytëzuar nga studentët dhe stafi akademik ka qënë dhe në gjuhë të huaj. Vet profili specifik i këtij programi studimi nuk lidhet me aftësimin e studentit në fushën e teknologjisë dhe informacionit. [ref: RVB; Minutat e Vizitës]
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësi që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Në takimin e realizuar me studentët e këtij masteri na u sqarua se njohuritë dhe aftësitë e tyre lidhur me këtë program studimi ishin në përputhje me strukturën e syllabuseve dhe programit të studimit. Organizimi i procesit mësimor si dhe gërshetimi i literaturës me analizat në mënyrë të vazhdueshme si dhe realizimi i detyrave plotësuese bënë të mundur plotësimin me njohuri dhe aftësi. Gjithashtu stafi akademik përpara përfundimit të lëndës realizonin përsëritje të aspekteve kryesore të saj. [ref: Minutat e Vizitës; RVB-ja]

Kriteri 4. Në përfundim të çdo lëndë/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Stafi akademik realizon përsëritje të aspekteve të rëndësishme të lëndës si përpara provimit të ndërmjetëm dhe përpara provimit final. Krahas orëve në auditor studentët mund të marrin sqarime të mëtejshme gjatë orëve të konsultave me lektorin e lëndës. Në takimin me studentët na u bë e ditur konsultimet me stafin akademik përtej procesit mësimor. [ref: RVB-ja; Minutat e Vizitës]
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Për vetë specifikat e MSH “Studime Religjose” stafi i brendshëm dhe i ftuar ka realizuar orë të hapura mbi zhvillimet më të fundit kryesisht në çështjet e sigurisë dhe aspekte të ngjashme. [ref: Minutat e Vizitës]
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Duke qënë se natyra e këtij masteri nuk mundëson punë në laboratorë, zhvillimi i procesit të mësimdhëniës realizohet mbi bazën e kompetencave duke lidhur punën individuale të studentit për realizimin e detyrave të kursit sëbashku me njohuritë e përfuara gjatë procesit mësimorë nga lektori përkatës. Gjithashtu zhvillimi i praktikës profesionale integron më tej njohuritë e përfuara me aplikimin në praktikë. [ref: RVB; Minutat e Vizitës]
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Një nga pikat e forta të evidentuara në takimin me studentët e këtij masteri ishte pikërisht organizimi nga ana e lektorëve i diskutimeve dhe realizimi i punëve në grup përgjatë procesit mësimor. Sipas tyre, aplikimi i punëve në grupë i kishte aftësuar në formimin e mendimit kritik dhe thellimit të analizave në fushën e religjonit. [ref: Minutat e Vizitës]
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Në dokumentin e Strategjisë së Kërkimit Shkencor si për periudhën 2017-2021 e konfirmuar kjo dhe në dokumentin e Strategjisë së re 2021-2025 (pika 12 e Strategjisë) institucioni inkurajon stafin akademik të realizoj botime me faktor impakti në revista ndërkombëtare. Gjithashtu vlen për tu përmendur dhe trajnimet në kudër të bashkëpunimit me Qendrën e Metodologjisë dhe Kërkimit. [ref: Strategjia e Kërkimit Shkencor UET]
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Në Statutin e Institucionit neni 6, manifestohet vizioni dhe ambicja e UET për të zhvilluar dhe mbështetur idetë inovative dhe studimet e avancuara. Institucioni mbështet vizionin e një “Universiteti Lider për zhvillimin e dijet, një qendër ekselence në formimin akademik të studentëve...një qendër ekselence për formimin shkencor..etj. Gjithashtu në dokumentin e Strategjisë së Kërkimit Shkencor, UET mbështet zhvillimin e ideve inovatore dhe kërkimin shkencor kështu në pikën 3.4 të këtij dokumenti, Institucioni synon: “Të

	realizojë një mjedis stimulus të kërkimit shkencor për stafin akademik dhe studentët nëpërmjet; 3.4.1 Standardizimit dhe ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor; 3.4.2 Strukturimit të një sistemi koherent të kërkimit shkencor dhe certifikimit të stafit akademik; 3.4.3 Trajnimit dhe certifikimit të aftësive të stafit akademik për të prodhuar dhe botuar dije origjinale shkencore; 3.4.4 Institucionalizimit të mëtejshëm të Projekteve të Mëdha Kërkimore (PMK) dhe grupeve kërkimore për rritjen e ndërdisiplinaritetit, maksimizimin e burimeve njerëzore. Bazuar në vizitën e kryer në institucion, nga takimet që GVJ zhvilloi me GVB, stafin akademik, studentët iu konfirmua fakti që institucioni i mbështet idetë inovatore të stafit dhe mbështet financiarisht studentëve me performancë të shkëlqyer. Duhet theksuar se studentët e këtij programi janë mbështetur me bursa për të realizuar këtë program studimi. [ref: Statuti UET; Strategjia e Kerkimit Shkencor UET 2017-2020 dhe 2021-2027; Minutat e Vizitës; RVB]			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë universitete në botë. Në dokumentin “Raporti periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve” jepet pasqyra e këtyre bashkëpunimeve. Aktualisht, ka 95 marrëveshje (memorandume bashkëpunimi) me IAL në Europë, Amerikë, Australi dhe Kinë, e njëkohësisht gëzon marrëveshje bashkëpunimi me 15 IAL shqiptare publike dhe jo publike. Përmes programeve të shkëmbimit, institucioni ka bërë të mundur përfshirjen e stafit akademik në projekte të përbashkëta si COST Action apo mobilitete në kuadër të Erasmus+ duke ndërthurur eksperiencat në dobi të procesit mësimdhënës dhe rritjes së bashkëpunimit. [ref: Raporti periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; Publikime dhe veprimtaria kërkimore e stafit 2017-2020; Analiza e Departamentit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në nivel institucioni, Universiteti ka një dokument të cilësuar: “Mbi punimin e diplomës/disertacionit” B.II i cili kategorizohet si “manual procedure” dhe përshkruan procedurën e posaçme vetëm për realizimin e diplomës dhe mbrojtjes së saj. Studentët e Masterit Shkencor “Studime Religjose” në përfundim të studimeve kanë realizuar mbrojtje të punimit të diplomës. Sikundër është përcaktuar dhe në Rregulloren Mësimore të programit të studimit pika 8.2 dhe 8.3: “Zgjedhja e temës dhe puna për shkrimin e punimit të diplomës nis që në fillim të vitit të parë akademik”. Në pikën 8.3 “...pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur.” Institucioni ka një procedurë të posaçme për realizimin e këtij procesi. [ref: Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomes dhe Disertacionit; Rregullore MSH Studime Religjose; RVB]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Strukturat përgjegjëse brenda departamentit kujdesen që studentët të orientohen në lidhje me literaturën përkatëse dhe të marrin gjithashtu orientime mbi shembujt e rasteve studimore që duhet të kenë në konsideratë për referim. Gjithashtu pedagogu udhëheqës realizon seanca të posaçme për ti ardhur në ndihmë studentit në këtë proces. [ref: Rregullore MSH Studime Religjose; Takimi me GVB; Takimi me studentët]
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Strukturat drejtuese të Departamentit krijojnë një komision të posaçëm për realizimin e mbrojtjes së temës së diplomës. Në këtë program studimi nuk realizohet provim final. Në vizitën e realizuar në sekretarinë mësimore evidentuam dokumentacionin e mbrojtjes së diplomës. Nga 6 studentët e këtij masteri 4 janë diplomuar. [ref: Vizita në Institucion].
Kriteri 4. Personeli akademik orienon dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Sikundër është përmendur dhe më herët në Rregulloren Mësimore të programit të studimit është përcaktuar koha se kur fillon puna për caktimin e temës së diplomës dhe rolin që ka pedagogu udhëheqës në këtë proces. [ref: Rregullore MSH Studime Religjose; RVB]
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në statutin e UET Neni 50 sanksionohen të drejtat dhe detyrimet e studentit. Institucioni i mbështet studentët me infrastrukturën që ka për ti asistuar në realizimin e punës kërkimore. Për vetë specifikat e fushës së këtij masteri roli i pedagogut është shumë i rëndësishëm sidomos për përcaktimin e metodologjisë dhe instrumentave të kërkimit.



	[ref: Statuti I UET; RVB]
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Puna kërkimore ku bazohet punimi i diplomës është një proces që nis herët me studentët e ciklit të dytë të studimit. Në këtë proces sikundër është vërejtur dhe në dokumentacionin e shqyrtuar janë të përcaktuara qartë rolet dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit Shkencor. Ai është autoriteti që garanton dhe miraton punimin e studentit. [ref: Dokumenti B.II "Mbi punimin e diplomes dhe Disertacionit"; Rregullore MSH Studime Religjose; RVB]
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Për mbrojtjen e punimit të diplomës studentët e masterit Shkencor "Studime Religjose" janë vlerësuar me notë. Sikundër është përcaktuar dhe në evidence Nr. 10 llogaritja e notës bëhet: "Për secilën Diplomë, Kryetari i Komisionit plotëson formatin përkatës dhe bën mbledhjen e pikëve të vlerësimit të udhëheqësit, oponentit dhe të secilit anëtar të Komisionit, e përpjesëton atë me numrin e vlerësuesve dhe bën konvertimin e rezultatit në notë përfundimtare, sipas sistemit të vlerësimit në fuqi. Në rastin kur udhëheqësi është edhe anëtar i Komisionit, vlerësimi i tij llogaritet vetëm një herë. Rezultati përfundimtar shënohet në Proces-verbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. [ref: Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomes dhe Disertacionit]
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Pasi ka përfunduar të gjitha detyrimet ndaj institucionit studentët pajiset me diplomë brenda një afati prej 6 muajsh. Gjithashtu gjatë kësaj kohe ai ka të drejtë që të pajiset me vertetim dhe listë notash. [ref: RVB]
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në rast të kërkesës nga ana e studentit, institucioni e mundëson një gjë të tillë. Në dokumentin "Mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore" pika 3.1 përcakton sekretarinë mësimore për administrimin e kërkesave të studentëve. Në këtë pikë thuhet se: "Sekretari i përgjithshëm trajton administrativisht të gjitha kërkesat/ankesat e studentëve [formati D.VI.3.1] që lidhen me aspekte administrative e akademike, dhe i përcjell ato me sqarimet e nevojshme tek autoriteti drejtues përkatës. [ref: Dok. E.I Mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore; RVB]
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Nga vizita në institucion dhe takimi me stafin e sekretarisë mësimore u pa dokumentacioni që ruante sekretaria për studentët e këtij masteri. Institucioni ruan për një periudhë pa afat një kopje të dokumentacionit të studentit. Institucioni mbanë një databazë të plotë me të dhënat e studentëve. [ref: RVB; Vizita në Institucion]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.	Përgjatë vitit 2018-2019 stafi i angazhuar në këtë program studimi janë angazhuar 8 personel akademik me kohë të plotë përkatësisht: 2 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc, 3 PhD. dhe 1 Dr. Personeli akademik me kohë të pjesshme ka qënë 3 përkatësisht: 1 Prof. Asoc. Dhe 2 Dr. Në vitin 2019-2020 u angazhuan 6 personel akademik me kohë të plotë dhe 1 me kohë të pjesshme por që mbulonte 2 lëndë në program. Gjatë vizitës në institucion në zyrën e burimeve njerëzore dosjet e personelit akademik si me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme ishin të plota. Institucioni kishte një dokumentacion të ruajtur dhe të përditësuar me të dhënat e stafit akademik i cili ishte i angazhuar në kuadër të këtij masteri. [ref: Analiza e Departamentit; Vizita në Institucion]
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni ka një procedurë të përcaktuar në dokumentin “Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerëzore”. Në këtë rregullore përcaktohen Politikën dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik; Kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mësimore; Trajtimi i rasteve të ekselencës së personelit apo dhe Kriteret dhe procedurat e marrjes lejë në UET. Gjatë vizitës në institucion me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore na u shpjeguar konkretisht procedura e ndjekur për stafin e rekrutuar në kuadër të këtij mëstëri.

	[ref: Dokumenti G. "Rregullore për Burime Njerëzore"; Vizita në Institucion; RVB]			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Evidentimi i nevojave për staf akademik realizohet nga Departamenti, i cili përcjell nevojat specifike për lëndë të caktuara në Dekanat dhe pas miratimit tek strukturat e burimeve njerëzore vijnë procedurën e shpalljes në njoftimit në faqen zyrtare të universitetit, rrjeteve sociale dhe gazetën Liberale. [ref. pika G.I.6 tek Dokumenti G. "Rregullore për Burime Njerëzore"; Takimi me përfaqësues të zyrës së Burimeve njerëzore; RVB]			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Institucioni realizon vlerësim dhe përzgjedhje të personelit mbështetur në procedurat e përcaktuara në dokumenta si Rregullorja e UET dhe Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerëzore. Strukturat përgjegjëse në institucion zhvillojnë procedurën duke iu përmbajtur nevojave për staf akademik sipas profileve të kërkuara nga njësitë bazë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Ambjentet e punës janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e detyrave nga ana e stafit akademik. Universiteti ka mjedis të përshtatshëm për realizimin e detyrave të personelit. [ref: Vizita në Institucion; RVB]
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni realizon disa nisma të cilat angazhojnë dhe nxisin stafin akademik për zhvillim profesional. Stafi përfshihet në organizimin dhe realizimin e konferencave shkencore, projekteve kërkimore, mobilitete në kuadër të programit Erasmus + etj. Institucioni mbështet, përmes skemës së financimit të kërkimit shkencor, stafin akademik që realizon botime të artikujve shkencor të indeksuara në Thomson-Reuters. [ref: Statuti UET; Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020; Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025 RVB]
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja,	Institucioni realizon trajnime 1-ditore në bashkëpunim me Qendrën e Metodologjisë dhe Kërkimit për të mundësuar kualifikimin e mëtejshëm të stafit në fushën kërkimore. Gjithashtu

për kualifikimin e mëtëjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimit-shkencor.	marrja pjesë e stafit në programet Erasmus + krijon mundësi për të përfituar nga eksperiencia dhe shkëmbimi i metodave inovative të mësimitdhënies. Institucioni mundëson dhe trajnimin e stafit akademik nga zyra e TIK mbi programet LMS etj. [ref: Të dhënat mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit; RVB]			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	Institucioni ka dëshmuar një angazhim serioz në mbulimin e programit me staf akademik me tituj dhe grada shkencore. Përgjatë vitin 2018-2019 personeli akademik me kohë të plotë i përfshirë në program ka qënë: 2 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc, 3 PhD. dhe 1 Dr. Profesionalizmi dhe kualifikimi i tyre mundëson përmbushjen e objektivave të programit. Duhet theksuar që për natyrën dhe specifikat e programit Master në “Studime Religjose” gjetja e ekspertëve për lëndë të caktuara nuk është e thjeshtë. [ref: Analiza e Departamentit; Minutat e Vizitës; Takimi me GVB]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimitdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimitdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në vizitën në institucion dhe dokumentat respektive, GJVJ konstaton se institucioni ka mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e proceseve akademike. Institucioni ka salla të kapaciteteve të ndryshme të ndara në salla leksionesh dhe seminaresh. Programi ka patur në total 7 student. Studentët e programit “Studime Religjose” kanë patur në dispozicion një infrastrukturë fizike, didaktike dhe logjistike për përmbushjen e realizimit të programit të studimit. [ref: Infrastruktura në dispozicion të programeve të studimit; Cilësia në hyrje dhe në dalje e MSH Studime Religjose; RVB]
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive	Në UET, auditorët janë të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektor, internet dhe foni. Infrastruktura në dispozicion të procesit mësimor për programin MSH “Studime Religjose” garanton realizimin e procesit mësimor. Përdorimi nga ana e studentëve dhe stafit akademik të sistemit MOODLE, UET-



bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	LMS (Sistemi i Menaxhimit të Mësimi) krijon infrastrukturën didaktike të aksesueshme në çdo kohë. [ref: RVB; Urdhër mbi përdorimin e platformës LMS; LMS-Guidë për pedagogun; LMS-Guidë për studentët]			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Institucioni e ka të gjithë infrastrukturën dhe mjetet e nevojshme për realizimin e programit të MSH “Studime Religjioze”. Në kuadër të këtij program studimi, për nga natyra e studimeve dhe specifikave të masterit nuk nevojiten laboratore, studio apo atelie që të kryhet procesi mësimor. [ref: RVB; Vizita në Institucion]			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni ka laborator të teknologjisë së informacionit, por për natyrën që ka ky program studimi nuk është i nevojshëm përdorimi i tij. [ref: Vizita në Institucion; RVB]			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Kapacitetet e UET dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktivitetëve të tjera. [ref: RVB; Vizita në Institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyset plotësisht	Përmbyset pjesërisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në nivel universiteti është një bibliotekë e vendosur në godinën C me një sipërfaqe 300 m ² . Biblioteka ka gjithsej 150 vende leximi, 12 kompjutera, dhe gjithë ambjenti është i mbuluar nga rrjeti Ëireless. Institucioni garanton të drejtën e studentit për aksesimin e bibliotekës përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin e literaturës fizike dhe jashtë ambjenteve të saj. Gjithashtu institucioni ka siguruar akses dhe në biblioteka online duke i mundësuar studentëve literaturën më të fundit. Gjatë vizitës në bibliotekën e UET-it për këtë master kishte një kënd me libra dedikuar Studimeve Religjioze.

	[ref: Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit MSH “Studime Religjize”; Vizita në Bibliotekë; RVB]
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka ka rreth 6425 tituj librash fizik (totali i librave Bruto, Periodik, Cd&Harta për VA 2019-2020) dhe ka infrastrukturë për aksesimin e titujve të librave në bibliotekat online. Biblioteka është abonuar për një periudhë 5-vjecare në libraritë elektronike Sage&Ebsco si edhe Questia. Seksioni i titujve fizik dedikuar MSH “Studime Religjoze” mundëson literaturën për studentet e këtij masteri, në bibliotekë ishin rreth 116 tituj fizik, 74 e-book dhe 27 tituj periodik e-book. Gjatë vizitës në institucion, nga punonjësja e bibliotekës u informuam mbi procedurat e pasurimit të fondit të bibliotekës. [ref: Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit MSH “Studime Religjize”; RVB; Vizita në Institucion]
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Regjistrimi dhe përdorimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në bibliotekë është pa pagesë për studentët dhe stafin akademik. [ref: Vizita në Insitucion; Takimi me punonjësën e bibliotekës]
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Institucioni është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). Në ambjentin e bibliotekës ndodhen 12 PC që janë në dispozicion të studentëve. UET është gjithashtu abonuar në libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questia, biblioteka dixhitale që përmbajnë revista akademike të cilat mund të aksesohen lirisht nga stafi dhe studentët. Përmes procedurës së regjistrimit në bibliotekë sigurohej akses për të gjithë studentët dhe stafin. [ref: Vizita në Insitucion; Takimi me punonjësën e bibliotekës]
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	UET-i ndjek një praktikë të pasurimit të fondit të bibliotekës sipas kërkesave që vinë nga njësitë bazë. Përgjegjësit e programit të studimit përmes kërkesave të marra nga stafi akademik me titujt e propozuar i përcjellin më tej në Dekanat duke filluar procedurën. Nga takimi që patëm me punonjësën e bibliotekës na u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsiderat kërkesat e stafit akademik dhe realizimi i procedurës për pasurimin e fondit realizohet në mënyrë periodike. [ref: RVB; Takimi me punonjësën e bibliotekës]
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të shtunë. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është 09.00-20.00 dhe ditën e shtunë qëndron e hapur deri në orën 17.00. Oraret e bibliotekës ishin në përshtatje të orareve mësimore. [ref: RVB; Takimi me punonjësën e bibliotekës]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UET ka një sistem të menaxhimit të informacionit të quajtur UMIS. Përmes këtij programi informatik realizohet ruajtja, administrimi dhe përpunimi i të dhënave të studentit nga regjistrimi deri në diplomim. Sistemi, ndër të tjerash, përmban të dhënat personale të studentit, regjistrimin e notave etj. [ref: RVB; Manuali i përdorimit të sistemit UMIS]
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Platforma MOODLE, UET-LMS mundëson komunikimin, informacionin dhe materialet që lidhen me procesin mësimor ndërmjet stafit akademik dhe studentëve në kohë reale. Ky sistem mundëson lehtësira si për studentët pasi ata informohen mbi rezultatet e testimit, njoftime, materialet e lëndëve etj dhe për stafin akademik që dokumenton punën e tij përmes sistemit. [ref: LMS-Guidë për pedagogun; LMS-Guidë për studentët; RVB]
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UET përmes sistemit të menaxhimit që përdor, në bazë të programeve të studimit mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët. Përmes sistemit UMIS dhe platformës UET-LMS institucioni mundëson dokumentacionin dhe komunikimin midis studentëve dhe stafit. Përmes përdorimit në nivel institucional të këtij sistemi realizohet gjithashtu monitorimi në kohë reale i aktivitetit akademik. Rezultatet pozitive të përdorimit të këtij sistemi u panë më shumë gjatë pandemisë, me lehtësimin e komunikimit në kohë reale mes stafit, studentit dhe IAL-se”. Vënia në funksion për një kohë të gjatë e sistemit UMIS dhe platformës UET-LMS i gjeti të përgatitur si stafin, administratën dhe studentët për ta përballuar më lehtë mësimin në distancë. [ref: LMS-Guidë për pedagogun; LMS-Guidë për studentët; RVB]
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të	Në UET sistemi LMS (Learning Management System) krijon mundësinë e komunikimit interaktiv dhe në kohë reale. Përmes

informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	kësaj platforme realizohen shkëmbime të informacionit midis stafit akademik dhe studentëve. Platforma LMS mundëson monitorimin e aktivitetit akademik nga strukturat e KSBC-së dhe jo vetëm. Sistemi i menaxhimi UMIS garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. [ref: LMS-Guidë për pedagogun; LMS-Guidë për studentët; RVB]		
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Në faqen zyrtare të Universitetit European të Tiranës (https://uet.edu.al/) informacioni ofrohet në gjuhën Shqipe dhe pjesërisht në gjuhën angleze. Faqa zyrtare e UET përmban informacion të larmishëm. Lidhur me programin e studimit MSH “Studime Religjose” nuk kishte informacion ne çeb-in e Universitetit pasi programi është përkohësish i pezulluar. [ref: RVB; faqa e https://uet.edu.al/]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ bazuar në RVB konstaton se raporti financiar hartohet në nivel institucioni gjatë muajti tetor të çdo viti. Raporti nuk është i ndarë sipas programeve specifike. Për vetë natyrën dhe funksionimin e universiteteve private nuk realizohen raporte në nivel programi studimi rrjedhimisht nuk kishte një raport financiar të kostove të tij. [ref: RVB]
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare,	Plani i financimit hartohet në nivel institucional. Për shkak të natyrës, funksionimit dhe organizimit të UET si dhe përfshirjes së stafit në disa programe studimi për të realizuar normën mësimore nuk është e mundur hartimi i raporteve në bazë programi. [ref: RVB; Takimi me stafin akademik]

grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Për këtë kriter GVJ është bazuar kryesisht në RVB, ku thuhet se UET ka raporte auditimi çdo vit dhe se ky raport hartohet nga audituesi ligjor i pavarur E.E.I shpk në lidhje me situatën financiare, performancën, bazuar në standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mungonin raportet e auditimit financiar të institucionit. Të dhëna të natyrës financiare janë pasqyruar në dokumentin Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB Tab. 18.2 ku konstatohet se gjatë tre viteve të fundit të ardhurat e buxhetit të Institucionit janë ulur. Konkretisht: Të ardhurat e përfituara nga Tarifat për dhe gjatë shkollimit a) viti 2017 / 1,401,315,636 lekë b) viti 2018 / 826.521.616 lekë c) viti 2019 / 663.300.718 lekë. Këto të dhëna janë rezultat edhe i uljes së numrit të studentëve në tre vitet e fundit (tab.18.1). Gjatë vizitës në institucion, nga dekania e fakultetit u theksua se një nga arsytet e pezullimit të këtij programi për vitin akademik 2020-2021 ishin kostot e larta për mbajtjen e tij, hapur me burimet e vetëfinansimit të institucionit. [ref. RVB; Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB; Takimi me Dekanen; Minutat e Vizitës]
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tre vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarevajtjen normale të tij.	Bazuar në RVB raportet përmbajnë transparencë përse i takon kontabilizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve. Në nivel institucioni raportet janë periodike, të përvitshme. Sikundër është theksuar dhe më lartë për këtë program studimi nuk ka një raport specifik financiar. [ref: RVB]
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	GVJ, bazuar në vizitën në institucion dhe takimin me përfaqësues të GVB dhe Stafin Akademik, u informua se për këtë program studimi institucioni ka ndjekur politikën e mbështetjes së tij duke ofruar dhe bursa për studentët e këtij programi. Për specifikat unike të programit të studimit politika e mbështetjeje është bërë me qëllim që ai të hapet dhe të shikohet ecuria e tij. Politika e mbështetjes mundësohet nga qëndrueshmëria financiare dhe forma e menaxhimit të qëndërzuar duke mundësuar shpërndarjen e kostove në nivel institucioni.

	[ref: RVB; Takimi në Institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni ka një kuadër të plotë të hartimit dhe zbatimit të procedurave për zhvillimin e aktivitetit akademik si: Statut, Rregullore Universitetit, Strategji, Vendimet e Senatit Akademik, Rregullore e Programit të studimit e deri tek Dok. D.I. “Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimin të studentëve”. Në dokumentin D.I “Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimin të studentëve” bëhet e qartë politika që ndjek institucioni dhe kriteret e pranimin për të tre ciklet e studimit që ofron ky universitet. Politikat e ndjekura në institucion janë konform legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore të universitetit. [ref: RVB; Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimin të studentëve]
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në bazë të dokumentacionit të shqyruar si: Statutit UET, Rregulloren e UET, Rregullore e Programit MSH Studime Religjoze, rezulton se politikat dhe procedurat e ndjekura nga UET përpara i takon pranimin dhe përfundimit të studimeve janë të njëjta për të gjithë studentët. [ref: Statuti UET, neni 32 (32.5-32.6); Rregullore UET Neni 11 dhe 12; Rregullore e Programit MSH Studime Religjoze]
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimin e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në dokumentacionin e shqyrtuar si Statuti i UET, Rregullore e UET dhe dokumenta të tjerë, vërehet që kriteret dhe procedurat e pranimin dhe të përzgjedhjes janë të kuptueshme dhe të aksesueshme. Studentët kanë mundësi që të aksesojnë kriteret e pranimin dhe të njohin procedurat qoftë nëpërmjet vizitës në institucion, takimeve informuese, broshurave dhe nëpërmjet faqes zyrtare të UET. [ref: RVB; Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimin të studentëve]
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Përpara fillimit të regjistrimit institucioni bënë publike kriteret dhe procedurën e pranimin për programet e ciklit të dytë të studimit. Kriteret specifike (nëse ka) propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Senati Akademik. Ky informacion është i aksesueshëm pasi publikohet në faqen zyrtare të universitetit. [ref: RVB; https://uet.edu.al/]

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Institucioni ka disa forma të informimit dhe orientimit mbi kërkesat e kriteret që ka programi i studimit si: takimet informuese në institucion; përdorimi i faqes zyrtare; rrjeteve sociale etj. [ref: RVB; Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimi të studentëve; Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në dokumente të tilla si: Rregullore e UET neni 29 “kalimi në vitin pasardhës”, Rregullore e programit të studimit MSH Studime Religjoze, dokumenti D.I Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimi të studentëve, dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore, gjëndet informacioni mbi kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentit. Gjithashtu përdorimi i platformave UMS dhe LMS, u mundëson studentëve informacion dhe njohje të vazhdueshme të përparimeve akademike në kohë reale. Studenti mund të informohet edhe pranë sekretarisë mësimore apo tek koordinatori i programit të studimit mbi përparimin e tij akademik. informacionit. [ref: Rregullore UET; Rregullore e programit MSH Studime Religjoze; D.I Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimi të studentëve; E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore]
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në Statutin e UET, neni 37 “Transferimi dhe njohja e periudhave të studimit”, në Rregullore UET, neni 35 “Transferimi dhe mobiliteti i studentëve”, sikundër dhe në Rregulloren mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin, janë të përcaktuara kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve. Më konkretisht, në nenin 35 të Rregullores së UET përcaktohet se: UET-i pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera, sipas procedurave të parashikuara me dokument të veçantë. Në çdo rast, studenti duhet të ndjekë në UET së paku një vit



	akademik. Studenti duhet të fitojë përmes programit të UET jo më pak se 25% të ECTS-ve në kategoritë e lëndëve A-D, si dhe të përmbushë detyrimet përmbyllëse (Kategoria E) të programit të studimit. Mbi këto dokumente bazohet realizimi i procedurës dhe informim mbi këto procese i studentëve. Gjithashtu Zyra ndaj Kujdesit të studentit në bashkëpunim me Departamentin informojnë dhe lehtësojnë studentin me vlerësime paraprake për transferim studimesh apo njohje të tyre. Duhet thënë se në këtë program studimi nuk ka patur asnjë rast ku të jenë transferuar studente tek ky program apo anasjelltas. [ref: Statut UET; Rregullore UET; Rregullore Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin]			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësi të studentëve në programin e studimit.	Rregullorja e programit të studimit dhe silabuset aksesohen online nga studentët. Në fillim të çdo semestri studentët informohen nga stafi akademik mbi procedurat e vlerësimit të dijeve. [ref: Takimi me stafin akademik; Silabuset e lëndëve]			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni organizon seanca informimi mbi punimin e diplomës. Ka dhe ndjek një procedurë të mirë përcaktuar në dokumentin B.II. "Mbi punimin e diplomës/disertacionit". GVJ u informua nga takimi me anëtarët e GVB dhe nga takimi me studentët për zbatimin konkret të këtij procesi. [ref: B.II. Mbi punimin e diplomës/disertacionit; Takimi me GVB; Takimi me Studentët]			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Në dokumentin Kalendari Akademik 2018-2019 apo 2019-2020 rezulton se institucioni organizon në fillim të vitit akademik "Javën e orientimit", përkatësisht në datat 8-12 tetor. Përgjatë javëve të regjistrimit, institucioni vendos grupe pedagogesh për të informuar studentët e interesuar. Gjithashtu, për një komunikim të institucionalizuar mes studentit dhe institucionit, ekziston një procedurë e përcaktuar në dokumentin A.V Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik. Në këtë dokument përcaktohet se: Tutoriati dhe këshillimi akademik zhvillohen gjatë gjithë vitit akademik (java e parë e Shtatorit – java e fundit e Qershorit) në të njëjtin orar (E premte 15:00-17:00), të shpallur që në fillim të vitit. Një burim tjetër informimi janë dhe mbledhjet e departamentit, të cilat zhvillohen të hapura për studentët e interesuar. [ref: Kalendari Akademik 2018-2019; Kalendari Akademik 2019-2020; A.V Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik; RVB]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Sikundër është përmendur edhe më lart në raport, institucioni ka disa forma të informimit të studentëve përsa i takon njohjes me strukturën dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, si psh “Rregullore e programit të studimit MSH Studime Religjoze”. Në këtë dokument, gjendet informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Gjithashtu, studenti mund të informohet përmes faqes zyrtare online të institucionit, përmes zyrës së kujdesit të studentit, nga stafi akademik, kontratës që nënshkruan me institucionin etj. Këto struktura dhe dokumente u mundësojnë studentëve informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit. [ref: Rregullore e programit MSH Studime Religjoze; RVB; Vizita në Institucion]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në dokumente të tilla si Statuti i UET, Rregullore e UET apo Rregullore programi studimi MSH në Studime Religjoze janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet që i takojnë studentit. Në Statut neni 50.1 përcakton se: “Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në UET...”. Që në momentin e regjistrimit, studenti pajiset me numër matrikullimi dhe gëzon të gjitha të drejtat e studentit. Ai pajiset me informacionin e duhur që lidhet me programin e studimit që përmban lëndët dhe modulet e tij. Institucioni siguron akses dhe informacion për studentët në lidhje me elementët e programit të studimit që ata ndjekin përmes platformës ëeb-it, platformës LMS dhe stafit akademik që realizon programin. [ref: Statuti i UET; Rregullore UET; Rregullore programi MSH Studime Religjoze; RVB; Vizita në Institucion]
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni ka disa struktura që adresojnë vënien në kontakt të studentëve me mundësitë e punësimit. Institucioni organizon panairë të tregut të punës si dhe ka strukturën e bordit të tregut të punës që mundëson lidhjen e studentëve të punësuar me universitetit. Gjithashtu zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit të Studentëve bënë njoftime për mundësi punësimi. [ref: RVB; Poster panairi i punës 2018 dhe 2019]

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimet e realizuara u informua mbi sistemin dhe strukturat përgjegjëse për informimin e studentëve mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Institucioni, përmes koordinatorit të programit të studimit mban komunikim dhe informonte studentët për njoftimet që lidheshin me procesin mësimor. Gjithashtu njoftimet vendoseshin dhe në këndin e njoftimeve. Njoftimi realizohej dhe në rrugë elektronike përmes postes elektronike të studentit apo sistemit LMS. [ref: Vizita në Institucion; RVB]			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në takimin e realizuar me studentët e programit MSH Studime Religjose u vërejt fakti se ata vlerësonin sistemin LMS. Sipas studentëve, sistemi u krijonte shumë lehtësi në komunikimin me stafin akademik të angazhuar në program, aksesin e leksioneve në formatin elektronik dhe çdo informacion tjetër që lidhet me organizimin e programit mësimor. [ref: Takimi me studentët; RVB]			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Gjatë takimeve të realizuara në UET, në zyrën e sekretarisë mësimore, GVJ pa dokumentacionin e administruar për studentët e këtij masteri. Institucioni përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit ruan dhe administron dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve. [ref: Takimi në sekretarinë mësimore; RVB]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve në programin e studimit.	Bazuar në Rregulloren e UET, neni 19 pika 1 dhe 2 thuhet se: “Regjistrimi i studentëve bëhet në katër regjistra: themeltar, i amzës, i diplomave, dhe i lëndës, të cilët mbahen në formë elektronike dhe në formë të shkruar. Regjistri themeltar, i amzës dhe i diplomave, bazuar në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin (MASR) për mbajtjen e tyre, plotësohet me të dhënat e studentëve në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Çdo student, në regjistrimin fillestar, pajiset me një numër unik matrikullimi, sipas udhëzimeve të


	MASR, numër që e shoqëron studentin deri në marrjen e diplomës. Gjatë vizitës në institucion, në zyrën e sekretarisë mësimore, GJVJ pa nga afër mënyrën e ruajtjes së dokumentacionin që lidhet me statistikat vjetore për numrin e studentëve të diplomuar në MSH “Studime Religjoze”. Rregjistrat e notave dhe ai themeltar ishin në kushte optimale, të plotësuar dhe të ruajtura në mënyrën e duhur nga stafi i sekretarisë. Të dhënat disponoheshin në versionin elektronik gjithashtu. Institucioni disponon statistika për studentët e diplomuar në vitin akademik 2019-2020 (4 studentë të diplomuar). [ref: Rregullore UET; E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore; Takimi në sekretarinë mësimore; RVB]
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GJVJ iu vu në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program, ata që ishin çregjistruar dhe ata që ishin me status aktiv. Nga të dhënat e sekretarisë rezultoi se të diplomuar janë 4 studentë, i çregjistruar 1 studentë, i pezulluar 1 studentë. Institucioni disponon të dhëna vjetore për programin MSH Studime Religjoze. Gjithashtu përmes sistemit LMS institucioni i disponon statistikat në çdo kohë. [ref: Minutat e Vizitës; Takimi në sekretarinë mësimore; RVB]
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	GJVJ gjatë vizitës në UET u informua se institucioni disponon për çdo student dosjen me të gjitha të dhënat që nga momenti i fillimit të programit dhe deri në përfundimin e tij. GJVJ, në takimin e realizuar pranë sekretarisë mësimore, pa nga afër dosjen e një studenti, e cila përmbante të gjitha dokumentat e duhura si: diploma dhe lista e notave e noterizuar, kontrata, ID etj. Përzgjedhja e saj u bë në mënyrë rastësore. [ref: Takimi në sekretarinë mësimore; RVB]
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Institucioni përmes sistemit UMIS realizon ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentëve. Zyra e IT-së është përgjegjëse për administrimin e të dhënave në sistem. [ref: RVB]
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre regjestrave	Në dokumentin Cilësia e studentëve në hyrje dhe dalje MSH Studime Religjoze, jepen të dhëna mbi cilësinë e performancës akademike të studentëve që kanë frekuentuar këtë master. Nota mesatare në hyrje e studentëve në të dy profilet ishte 7.53 dhe në dalje nota mesatare ishte 8.84. Në lidhje me punësimin të dhënat gjenden në dokumentin Tabelë përmbledhëse për punësimin

	real të studentëve (Aneks tabela 24). Nga katër studentë të diplomuar, 2 prej tyre janë të punësuar në përputhje me diplomën e marrë, një studente është e punësuar por jo në përputhje me diplomën dhe një studente e diplomuar është e papunë. Gjithashtu, departamenti ka realizuar një analizë mbi arritjen e objektivave formues të programit të studimit duke analizuar komponente të tillë si: A. Burimet Njerëzore B. Programi akademik C. Ngarkesa për çdo pedagog D. Pjesëmarrja në projekte E. Objektiva 2019-2020. studimi. [ref: Cilësia e studentëve në hyrje dhe dalje MSH Studime Religjose; Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve (Aneks tabela 24); Analiza e departamentit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Bazuar në Statutin e UET, studentët përfshihen në disa struktura drejtuese me karakter mesimor-kërkimor dhe shërbime. Përfaqësuesit e studentëve përfshihen në struktura si: Senati Akademik; Këshilli i Studentëve/Këshillat e Studentëve në nivel njësie kryesore; 1 student në Këshillin e Etikës; 1 student në KSBC. [ref: Statuti UET; RVB]
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Krahas detyrimeve të përcaktuara në Statut dhe Rreguloren e UET, institucioni përdor disa forma të përfshirjes së studentëve dhe në vlerësimin e procesit akademik përmes Fokus Grupeve dhe Pyetësorët Online. Rezultatet e këtyre instrumentave trajtohen në nivel të strukturave drejtuese. Nga vizita në institucion dhe takimi që kemi patur me përfaqësues të KSBC na u sqarua procedura dhe realizimi i këtij procesi. [ref: Takimi me përfaqësues të KSBC-së; RVB]
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në	Për analizën e këtij kriteri, GVJ shqyrtoi një sërë dokumentash, si Plani mësimor i studimit MSh Studime Religjose, dokumentin Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese dhe dokumentin Analiza e departamentit. Sikundër vërehet dhe nga shqyrtimi i



programin e studimit dhe parashtikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	dokumentacionit dhe nga rezultatet e Analizës së Departamentit, ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimit profesional. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Ka një ndarje të balancuar të ngarkesës mësimore në të katërt semestrat, gjë që i jep mundësi studentëve të mos jenë të mbingarkuar dhe të realizojnë një program të mirë koordinuar midis semestrave. [ref: Plani mësimor i studimit MSh Studime Religjose; Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese; Analiza e departamentit; Takimi me studentët; RVB]			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Gjatë takimit në institucion me dekanen/drejtuesen e departamentit u theksua rëndësia dhe vlera e përfshirjes së studentëve në procesin e vlerësimit të procesit akademik si dhe realizimi i mbledhjeve të departamentit në formatin e hapur ku ftohen dhe studentët. [ref: Takimi me dekanen; RVB]			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët si dhe nga kqyrja e dokumentacionit vërehet se studentëve u mundësohet transparenca dhe barazia në marrjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Në Rregulloren e Universitetit, përcaktohet procedura në rast ankese nga studenti (neni 32 “Kërkesa për Rivlerësim”). Sipas kësaj procedure, studenti realizon ankesën pas shpjegimeve përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Studenti mund t’i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e komponentit përkatës në tezë. Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar...etj [ref: Rregullore UET; Takimi me studentët; RVB]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Nga shqyrtimi i CV-ve e veprimtarisë kërkimore - shkencore e botuese të personelit akademik, me kohë të plotë e të pjesshme të programit MSH në Studime Religjose, rezulton se personeli akademik i angazhuar në MSH Studime Religjose realizon punë kërkimore në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu në dokumentin Analiza e Departamentit theksohet se: “Pedagogët efektivë të departamentit janë të përfshirë në projekte, përkatësisht: Programi Erasmus: të gjithë pedagogët. Kjo përfshirje realizohet nëpërmjet mësimdhënies jashtë vendit, në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit, të nënshkurara nga IAL; Trajnimet e personelit akademik për çështje didaktike dhe të metodave kanë qenë sistematike. Personeli akademik i UET ka mundësi të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, duke shfrytëzuar edhe përdorimin e metodave të reja, përmes periudhave të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve Erasmus+ KA1.” Sygjerohet që në të ardhmen stafi akademik të realizoj kërkim shkencor të lidhur me fushën e studimit të këtij Masteri. [ref: CV e stafit të programit; Analiza e Departamentit; Minutat e Vizitës; Publikimet dhe veprimtaria kërkimore e stafit akademik 2017-2020; RVB]
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	UET ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Aktualisht, ka 95 marrëveshje (memorandume bashkëpunimi) me IAL në Europë, Amerikë, Australi dhe Kinë dhe, njëkohësisht, gëzon marrëveshje bashkëpunimi me 15 IAL shqiptare publike dhe jo publike. Një pjesë e stafit është e angazhuar në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare (si COST, Erasmus etj). [ref: Raporti periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; Publikimet dhe veprimtaria kërkimore e stafit akademik 2017-2020;]
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	Motivimi dhe angazhimi i stafit akademik për të përfshirë studentët në aktivitete kërkimore gjendet dhe tek dokumenti Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020. Në pikën 1.2 të dokumentit të Strategjisë së kërkimit shkencor thuhet se: “Kërkimi shkencor në UET është në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së

	stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore”. Gjithashtu, bazuar në RVB dhe takimet e realizuara me GVB me stafin akademik dhe studentët, GVJ u sqarua se një angazhim shumë i rëndësishëm për të përfshirë studentët në punë kërkimore është dhe punimi i diplomës. Në këtë proces, studenti përfshihet që në vitin e parë të studimeve. Lidhur me procesin e realizimit të disertacionit, ai është i përcaktuar në dokumentin B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit. Stafi akademik dhe studentët motivohen që të realizojnë punë serioze kërkimore. [ref: Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020; B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit; Vizita në institucion]				
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Në dokumentin Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020 është e përcaktuar struktura e kërkimit shkencor. Institucioni mbështet dhe përfshin stafin akademik në disa struktura si: Projektet e mëdha Kërkimore (PMK) a. Grupet Kërkimore (5-7 anëtarë) b. Projektet Kërkimore Individuale dhe ka Bord të Botimeve në UET Press. Gjithashtu stafi akademik mund të publikojë në revistat e universitetit si: Polis Journal; Economicus Journal; Medicus Journal. Gjithashtu institucioni realizon dhe disa aktivitete shkencore si: 6. Konferenca DSSH; Anuarët e Filozofisë; Rrethi Liberal i Dardhës; Ditët e Letërsisë në Razëm. Institucioni ka një buxhet financiar prej 75.000 euro në vit, dedikuar kërkimin shkencor. Përmes këtij fondi, institucioni mbështet stafin akademik në aktivitete studimore, kërkimore e shkencore. Institucioni inkurajon anëtarët që të publikojnë në revista shkencore ndërkombëtare të indeksuara dhe me faktor impakti. [ref: Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020; RVB]				
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit nuk ka evidenca për angazhime të stafit akademik për studime inovative.				
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Institucioni ka infrastrukturë logjistike për realizimin e analizave/matjeve në kuadër të kërkimit shkencor. Gjithashtu, stafi akademik ka detyrimin për ti ofruar studentit asistencën e nevojshme për realizimin e punimit të diplomës. [ref: Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit; RVB]				
	<table><tr><td></td><td>Përbushet pjesërisht</td><td>Përbushet kryesisht</td><td>Përbushet plotësisht</td></tr></table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi V.7
Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Institucioni realizon një politikë bashkëpunimin me institucione vendase dhe të huaja. Bazuar në Planin strategjik të UET, institucioni synon që të jetë “pjesë integrale e rrjeteve dhe strukturave të organizuara institucionale universitare në kuadrin e rajonit të Europës jug-lindore, vendeve të bashkimit Europian dhe më gjerë vendeve anëtare të OCDE-së”. Institucioni ka 95 marrëveshje (memorandume bashkëpunimi) me IAL në Europë, dhe marrëveshje bashkëpunimi me 15 IAL shqiptare publike dhe jo publike. Të gjitha këto bashkëpunime kanë krijuar mundësi mobiliteti për stafin dhe studentët. Përsa I takon këtij program studimi nuk rezultojnë që studentet të kenë realizuar mobilitet. [ref: Plani strategjik 2015-2020; Raporti periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; RVB]
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Në planin mësimor të studimeve MSH Studime Religjose ka lëndë që kontribuojnë në përgatitjen e studentëve në fushën e kërkimit shkencor. Në strukturën e vlerësimit të çdo lënde ka një detyrë kursi që praktikisht është një mini kërkim dhe që gradualisht gjatë dy viteve e përgatit studentin dhe për të hulumtuar më mirë në realizimin e punimit të diplomës. Me përfundimin e këtij Masteri, studentët mund të vijojnë studimet e ciklit të tretë. [ref: Plani mësimor i studimit MSH Studime Religjose; RVB]
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se në strategjinë e kërkimit shkencor të UET përfshihet edhe mbështetja e produktivitetit kërkimor shkencor të personelit akademik të ri (Junior researchers). Kërkimi shkencor në UET është konceptuar në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies e mësimnxënies, nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore. Projektet e Mëdha Kërkimore përbëjnë shtyllën e kërkimit shkencor e janë instrumenti kryesor i drejtimit dhe gjenerimit të punimeve dhe botimeve shkencore në UET.



	[ref: Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020; RVB]		
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruuese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Institucioni ka ndërtuar një politikë bashkëpunuese me 95 institucione jashtë vendit duke mundësuar bashkëveprim dhe shkëmbime ndërmjet stafëve. Në kuadër të aktiviteteve me karakter kërkimor e shkencor janë përfshirë kërkues shkencor të huaj. [ref: Plani strategjik 2015-2020; Raporti periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; RVB]		
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Institucioni në kuadër të ndërkombëtarizimit ndjek politika favorizuese për rritjen e mobilitetit të studentëve. Duhet thënë që efektet e pandemisë Covid dhe numri i ulët i studentëve ka ndikuar në faktin që nuk ka patur mobilitet të studentëve të këtij masteri. [ref: Plani strategjik 2015-2020; Raporti periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; RVB]		
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Në kuadër të këtij masteri është angazhuar personel akademik i huaj në procesin mësimor. Gjithashtu institucioni në kuadër të ndërkombëtarizimit ka realizuar veprimtari të ndryshme kërkimore ku janë përfshirë studentë dhe staf akademik i huaj. Lëndë të tilla si “Filozofia e Religjonit” apo “Religjioni dhe debatet bashkëkohore” janë mbuluar nga Dr.Hasaflok dhe Prof.Asoc.Dr. Giakoumis. Sikundër u pohua dhe gjatë takimit me studentët e këtij masteri, përfshirja e stafit akademik të huaj ishte një vlerë e shtuar e këtij program. [ref: CV_David Hosaflok; CV_Kosntandinos Giakoumis; Analiza e Departamentit; Vizita në Institucion; RVB]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka një zyrë të Kujdesit ndaj Studentit (ZKS). Ajo shërben si burim primar i informacionit dhe këshillave rreth mundësive të studimit. Anëtarët e stafit ndihmojnë studentët të përfshihen në jetën e kampusit, i mësojnë studentët në lidhje me

	politikat e Universitetit, ndërmjetësojnë mosmarrëveshjet organizative dhe individuale, këshillojnë programe dhe aktivitete të veçanta, mbështesin studentët për qeverinë studentore, menaxhojnë hapësirën ku qëndrojnë studentët e qeverisë. [ref: Dokumenti E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; RVB]			
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni ka një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin e studentëve në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit. Që në fillim të vitit akademik shpallet kalendari i tutoriatit dhe këshillimi akademik zhvillohen gjatë gjithë vitit akademik me orare të përcaktuara. Brenda këtij orari zhvillohen edhe seancat metodologjike. Çdo anëtar i personelit të brendshëm akademik ka në ngarkim një grup studentësh dhe qëndron 1 (një) orë në javë në një zyrë/sallë të caktuar, në funksion të këtij shërbimi, gjatë një orari pa ngarkesë mësimore ose administrative. [ref: Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik]			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Tutoriatit dhe këshillimi akademik zhvillohen gjatë gjithë vitit akademik (java e parë e Shtatorit – java e fundit e Qershorit) në të njëjtin orar (E premte 15:00-17:00), të shpallur që në fillim të vitit. Brenda këtij orari zhvillohen edhe seancat metodologjike. Çdo anëtar i personelit të brendshëm akademik ka në ngarkim një grup studentësh dhe qëndron 1 (një) orë në javë në një zyrë/sallë të caktuar, në funksion të këtij shërbimi, gjatë një orari pa ngarkesë mësimore ose administrative. Studenti këshillohet të ruajë kontaktet me të njëjtin pedagog përgjatë gjithë ciklit të studimeve. [ref: Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik]			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra e Këshillimit dhe Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar, dhe ka një bazë të dhënash në lidhje me punësimin apo vazhdimin e mëtejshëm të studimeve të tyre. Institucioni ka një shoqatë Alumnit dhe realizon takime periodike me ta. Ata janë gjithashtu pjesë e bordeve të tregut të punës pranë departamenteve. [ref: E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Vizita në Institucion; RVB]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UET janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC). [ref: Statuti UET; Rregullore UET]
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Institucioni ka Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) i cili ka për detyrë vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore e kërkimore. KSBC ka akses në të gjitha të dhënat e UET. Institucioni ka Strategji për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017 – 2022 për realizimin e objektivave të cilësisë. Gjithashtu zyra e Standardeve dhe Cilësisë realizon politikat, strategjitë dhe proceset për të garantuar cilësinë në UET. Institucioni angazhon dhe ekspertë të jashtëm pranë KSBC-së. [ref: Statuti UET; Rregullore UET; Strategji për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017 – 2022; RVB]
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Institucioni përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit në mënyrë të vazhdueshme. [ref: RVB]
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e	Institucioni ka politika dhe procedura të qarta përsa i takon sigurimit të cilësisë. Struktura përgjegjëse KSBC, programon punën në bazë të strategjisë/manualit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, dhe planit të veprimit të përvitshëm. Rezultatet e marra



kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit	nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen në dispozicion të strukturave drejtuese të njësive bazë. [ref: Strategji për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017 – 2022; Plani i veprimit KSBC; RVB]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Në Statutin e UET, neni 11 i tij përcaktohet se: “UET harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm”. Në rregulloren e institucionit përcaktohet zyra e Standardeve dhe Cilësisë si dhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) i cili vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore-shkencore, të UET-it. Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë është KSBC-ja. Në nivel njësie bazë është Departamenti i cili ka programin e studimit së bashku me strukturat e tij të brendshme si koordinatorët e programeve dhe përgjegjësit e grup-lëndëve. [ref: Statuti i UET; Rregullore UET; RVB]
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Ka disa dokumenta ku vërtetohet se institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin e syllabuseve dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit. Kështu, në dokumentin A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës, përcaktohen parimet mbi të cilat duhet të mbështetet stafi akademik për ndërtimin e tyre. Gjithashtu në dokumentin Metodologjia e punes së aktiviteteve të KSBC, thuhet se: “Gjatë shqyrtimit (të syllabusit) duhet të vlerësohet përputhshmëria (ose jo) e syllabusit të hartuar me formatin standard të UET. Specifikisht verifikohen këto elementë: I. Miratimi (ose jo) i silabusit nga: a) Përgjegjësi i Grup-Lëndës b) Përgjegjësi i Departamentit II. Nënshkrimi (ose jo) i silabusit nga titullari/pedagogët e lëndës (të gjithë) III. Plotësimi korrekt (ose jo) i elementëve/seksioneve që përmban silabusi, sipas UDHËZIMEVE (bashkëlidhur). Më konkretisht, kryetari i KSBC kryen ndarjen e



	punës midis anëtarëve të Komisionit, shpërndan dokumentet dhe udhëzimet e nevojshme për kryerjen e vlerësimit të planeve lëndore. Gjatë realizimit të procesit, konstatimet e anëtarëve të KSBC gjatë shqyrtimit të planeve lëndore, shënohen në matricat përkatëse për çdo Fakultet. Në përfundim, anëtarët e KSBC i dorëzojnë Kryetarit matricat përkatëse për hartimin e Raportit përmbledhës të përputhshmërisë së planeve lëndore. Institucioni përmes KSBC-së realizon raporte vlerësimi periodike vjetore mbi elementë të ndryshëm të programeve të studimit në nivel Universiteti. Përmbajtja e raporteve trajtohet në disa nivele brenda institucionit. [ref: A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literatures; Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC; RVB]
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarevajtjen e programit të studimit.	Në UET funksionojnë mekanizma monitorimi dhe vlerësimi periodik të aftësive dhe progresit në procesin mësimdhënës të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, aplikohen: format e vetëvlerësimit, të vlerësimit nga studentët, të vlerësimit të mësimdhënies në auditor për lektor e asistent lektor nga Dekani, përgjegjësi i njësisë bazë apo përgjegjësit e grup-lëndëve. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu është i zbërthyer në indikatorë të detajuar, që mundësojnë një proces vlerësimi për një sërë komponentë të përmbajtjes e organizimit të mësimi, të pedagogjisë e komunikimit me studentët etj. Në planin vjetor të veprimit të KSBC përfshihet kontrolle periodike të syllabuseve, përpunimi i të dhënave të pyetësorit online të studentëve, të pyetësorit me fokus-grup, etj. Institucioni dhe struktura përgjegjëse KSBC përmes planit të veprimit të përvitshëm si dhe aktiviteteve me karakter monitorues nga Departamenti dhe njësia kryesore realizon vlerësimin në nivel institucional të të gjitha programeve të studimit. [ref: Minutat e Vizitës; Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu; Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi syllabuset; Plani i veprimit KSBC; RVB]
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në dokumentin Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë (pjesa e 4 “Procedurat dhe aktivitete për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë) janë të përcaktuara me detaje instrumentat mbi të cilat ndërtohet raporti (të përmendura dhe më lart). Gjithashtu, një dokument shumë i rëndësishëm është dhe F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ku në pikën F.VII.7.6. ku thuhet se “Rezultatet e KSBC-së publikohen përmes një raporti të brendshëm që i dërgohet Rektorit dhe Administratorit të UET. Pjesët e raportit që lidhen me



	Fakultetet përkatëse u vihen në dispozicion edhe Dekanëve të Fakulteteve dhe Drejtuesve të Departamenteve”. GVJ, në takimin e realizuar me përfaqësues të KSBC, u sqarua se për të realizuar raportet periodike, zyra e KSBC-së përdor disa forma vetëvlerësimit dhe se raportet e realizuara nga KSBC-ja janë në dispozicion të strukturave drejtuese dhe stafit. Këtu mund të përmëndim dokumentin Format raporti për provime, Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët. Rezultatet e raporteve trajtohen në disa nivele brenda institucion. [ref: Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Plani i veprimit KSBC; Format raporti për provime; Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët; Takimi me përfaqësues të KSBC; RVB]			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Bazuar në dokumentin Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë, struktura e raporteve të vlerësimit përfshin rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. Pjesët e raportit që lidhen me fakultetet përkatëse u vihen në dispozicion dekanëve të fakulteteve dhe drejtuesve të departamenteve, të cilët diskutojnë me stafin mbi vlerësimin e marrë dhe hapat që do të ndjekin për përmirësimin e mëtejshëm të njësive. Bazuar në RVB-në monitorimi i procesit të përmbushjes së masave në kuadër të mangësive të konstatuara realizohet nga KSBC-ja. [ref: Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; RVB]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit	Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është garantimi i cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe financiare të UET-it. KSBC-ja realizon vlerësim periodik në nivel institucional tek të gjitha programet e studimit. Kjo strukturë nuk harton relacione specifike

apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	në bazë programi. Departamenti ka realizuar një analizë të përgjithsme për programin e studimit MSH Studime Religjoze. [ref: Dokumenti F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; RVB]
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Nga takimi më anëtarë të KSBC (dhe shqyrtimi i RVB-së) na u bë me dije se përdoren disa instrumeta për realizimin e procesit të vlerësimit si: Në çdo semestër me anë të sistemim LMS realizohet vlerësimi për çdo lëndë të çdo pedagogu nga studentët; Përdorimi i fokus grupeve; Vlerësimi nga Përgjegjësi i Departamentit; Folloë up me stafin etj. [ref: Vizita në institucion; RVB]
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rreguluara dhe të tjera.	Nga takimi me dekanen/përgjegjësen e departamentit dhe shqyrtimi i dokumentacionit na rezulton se institucioni përdor forma të ndërthurura për realizimin e vlerësimit dhe ruajtjes së cilësisë së programit të studimit. Për kategorinë lektor/asistent lektor realizohen monitorime nga ana e eprorëve dhe për këtë ka një format standard ku përfshihen komponentë si organizimi dhe qartësia e leksionit; komunikimi me studentët etj. Në përfundim të procesit hartohet një raport vlerësimi mbi rezultatet e monitorimit. Gjithashtu vlerësimi që japin studentët për procesin mësimor nga sistemi LMS është një tjetër instrument. Format i vlerësimit të performancës akademike të studentëve bëhet nga një ndërthurje instrumentash si testim me shkrim, detyra kursi, aktivizimi etj. [ref: Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Vizita në Institucion; Takimi me Dekanen, Stafin Akademik; Takimi me GVB; RVB]
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program	Nga takimi i GVJ me studentë të programit të studimit, përfaqësues të KSBC, përfaqësues të Zyrës së Kujdesit për Studentin, raporti i GVB, rezulton se institucioni përdor disa metoda e instrumente vlerësimi. Institucioni garanton rolin e studentëve në procesin e vlerësimit periodik të metodave të mësimdhënies, të tërheqjes së mendimit të tyre mbi programet studimore e modulet e lëndëve, mbi cilësinë e aksesin e literaturës, mbi etikën e komunikimit të pedagogëve. Format e aplikuar për këtë qëllim janë pyetësorët e formularët e administruar nga KSBC dhe takimet periodike me studentët në formën e “fokus-grupeve”. Këto instrumenta analizohen dhe, nëpërmjet tyre, evidentohen problematikat e ndeshura në procese kyçe të veprimtarisë mësimore – kërkimore (të tilla si: shpërndarja e ngarkesës mësimore në nivel departamenti,

	kualifikimi i personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, cilësia e mësimdhënies dhe çështje të vlerësimit të studentëve, etj.),”. Në të gjithë këtë proces, KSBC është struktura përgjegjëse për realizimin e procesit të vlerësimit dhe hartimin e raporteve me gjetjet përkatëse në nivel institucional. [ref: Minutat e Vizitës; Rregullore e UET; Dokumenti F. VII Mbi sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Dokumenti E.VII Mbi Funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës e Kujdesit ndaj Studentit; Formular për ankesat e studentëve; Formati i vlerësimit të pedagogut nga student; RVB]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Sipas Rregullores së UET, standardet dhe cilësia, përfshijnë disa struktura si: a. Zyra e Standardeve dhe Cilësisë b. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore-shkencore, të UET-it. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të tij rregullohet me dokument të veçantë. c. Zyra e Burimeve Njerëzore d. Zyra e Kurrikulave. Institucioni realizon politika dhe procedura të brendshme të cilësisë duke përfshirë disa aktorë në proces si: Bordet e tregut të punës; ekspert të jashtëm; përfshirja në projekte ndërkombëtare me fokus sigurimin e cilësisë së brendshme si TEMPUS “ENCHASE” dhe Erasmus+ QAINAL. Përfshirja në këto projekte ka krijuar shkëmbime përvojash, trajnime, vizita studimore si dhe procese të tjera që lidhen me monitorimin dhe vlerësimin e funksionit të sigurimit të cilësisë së brendshme. [ref: Rregullore UET; Fisha e projektit ENCHASE; Fisha e projektit QainAL; RVB]
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të	Në dokumente të tilla si: Statuti i UET; Rregullore UET, Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë, dokumenti F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë të përcaktuara përgjegjësitë dhe detyrat e njësive të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë. Më konkretisht zyra e



studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikën e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit. Ndërsa Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. [ref: Statuti UET; Rregullore UET; Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; RVB]
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Në dokumentin F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë thuhet se KSBC ngrihet në nivel universiteti dhe anëtarët e tij propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati i Universitetit. Në pikën F.VII.7.2. të këtij dokumenti përcaktohet përbërja e Komisionit i cili ka një Kryetar, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm. Ka disa standarde të cilat respektohen për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit-KSBC-së (si: kompetenca profesionale, paanshmëria...etj). Komisioni funksionon që prej vitit 2009, kompozimi i komisionin (KSBC) ka përfaqësues nga të gjithë fakultetet e UET, ka përfaqësues nga personeli administrativ dhe nga studentët. Komisioni operon me një plan vjetor që miratohet në fillim të vitit nga Rektori. Komisioni fokusohet tek shqyrtimi i syllabuseve, tezave të provimit etj. Sikundër është trajtuar dhe më lart, raporti është në nivel institucional. KSBC-ja nuk realizon raporte në nivel program studimi. Departamenti ka realizuar një analizë mbi ecurinë e programit të studimit. [ref: Statuti UET; Rregullore UET; Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Analiza e Departamentit; RVB]
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj pabarazie kundrejt stafit dhe studentëve. Realizimi i pyetësorëve të vlerësimit të stafit akademik nga ana e studentëve bëhet duke ruajtur anonimin e studentit. Për të shmangur subjektivitetin e vlerësimit të studentëve, pyetësi realizohet para dhënies së

		provimit; në këtë mënyrë, studenti nuk influencohet nga rezultati për mendimet e shprehura në pyetësor. Gjithashtu, në raste të problematikave të evidentuara nga përpunimi i të dhënave dhe trajtimi i tyre në raport, personeli akademik informohet nga eprori mbi rezultatet e dala. Duhet theksuar gjithashtu fakti që, për përzgjedhjen e anëtarëve të KSBC, ruhen disa standarde të tilla si: kompetenca profesionale, paanshmëria, nuk duhet të jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të universitetit, etj. Këto kritere e bëjnë punën e KSBC efikase dhe të paanëshme. [ref: Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Vizita në institucion; RVB]		
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Institucioni angazhon ekspertë të jashtëm në strukturën e KSBC-së. Në pikën F.VII.7.2. të dokumentit F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë thuhet se: “Komisioni përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm”. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë dhe studentët e diplomuar dhe të punësuar të cilët janë pjesë e strukturës e Bordi i Tregut të Punës, të cilët japin kontribut në këtë proces. [ref: F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Bordi i Tregut të punës; RVB]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vepron në bazë të një plani veprimi vjetor të miratuar nga Rektori i Institucionit. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017 – 2022 janë gjithashtu dokumenta të cilët përcaktojnë politikat dhe organizimin e veprimtarisë në kuadër të sistemit të brendshëm



		të cilësisë. Këto dokumenta sikundër pranohet në RVB fq.74 “...raportet e KSBC-së përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat raportit ka ndikim të drejtpërdrejtë” [ref: Plani i veprimit KSBC; Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017 – 2022 RVB]				
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.		Vlerësimi është në nivel institucional, dhe rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese dhe në departament trajtohet me stafet akademike elementë që lidhen me veprimtarinë e tyre. Raportet e KSBC-së nuk janë të aksesueshme, <i>sygjerohet një përmbledhje e rezultateve të raportit dhe masave propozuese, të jenë publike dhe e aksesueshme për studentët dhe më gjerë.</i> [ref: F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; RVB]				
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.		Institucioni realizon një proces vijueshmërie të rezultateve dhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat i raportit. Sipas RVB-së disa nga masat e marra lidhen me aktivitete për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve akademike përmes realizimit të seminareve të trajnimit me natyrë didaktike të mësimdhënies apo për kërkimin shkencor. [ref: F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; RVB]				
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.		Përpyqjet për të reflektuar gjetjet e raportit sikundër dhe monitorimin janë në nivel institucional. Përmes kontrollit të kryqëzuar, strukturat dhe aktorë të brendshëm të UET reflektojnë mbi rezultatet e raportit dhe realizojnë masa që lidhen me programet e studimit për ta përmirësuar më tej. [ref: F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; RVB]				
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit		Realizimi i vlerësimit të përvitshëm nga ana e KSBC-së përmes planit të punës mundëson angazhimin e strukturave akademike dhe studentët në proces. Aksesit në dokumentat ku bazohet kjo veprimtari është e mundur si për stafin akademik, administrativ dhe studentët në nivel institucional. [ref: Plani i veprimit KSBC; F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; RVB]				
		<table><tr><td></td><td>Përbushet pjesërisht</td><td>Përbushet kryesisht</td><td>Përbushet plotësisht</td></tr></table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Xuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave/Arteve “Studime Religjoze” me profile të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Masteri “Studime Religjoze”, me profilet “Krahasimi i Religjioneve”, “Çështje të sigurisë”, është një master unik dhe risi në ofertën akademike shqiptare, që i shërben ruajtjes dhe promovimit të interesave dhe vlerave kombëtare.
2. Universiteti Europian i Tiranës ka një infrastrukturë fizike, didaktike e logjistike bashkëkohore që mundëson realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.
3. Universiteti disponon një kuadër të plotë ligjor dhe rregullator, që mundëson disiplinimin e procesit mësimor e kërkimor - shkencor dhe një praktikë shumë të mirë të ruajtjes së dokumentacionit sipas standardeve dhe kërkesave ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Universiteti ka një sistem informatik eficient dhe përdor platforma digitale që i vinë në ndihmë studentëve, duke mundësuar akses dhe informim në kohë reale.

Pika të dobta

1. Promovimi i pamjaftueshëm i programit për publikun e interesuar, nisur nga rëndësia dhe aktualiteti i masterit, në kontekstin e dinamikave të zhvillimit, kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Një ndërveprim jo i mjaftueshëm i strukturave të universitetit për njohjen e këtij programi pranë institucioneve shtetërore dhe fetare, publike dhe private si dhe të shoqërisë civile, të interesuara për ekspertë në fushën e “Studimit të Religjionit”.
3. Mungesa e një studimi paraprak mbi qasjen e nevojave të tregut për MSH Studime Religjoze.
4. Vërehet mungesa e ekspertëve me një background kërkimor e shkencor të posaçëm në fushën e studimeve dhe të krahasimit të religjioneve.
5. Vërehet mungesa e projekteve kërkimore/ forume/ konferenca shkencore me fokus të veçantë në studimet e religjionit, që mund të bashkëveprojnë me programin e studimit.
6. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërehet se konteksti shqiptar i historikut, përmbajtjes dhe problematikave aktuale të dialogut ndërfaqetarak mund të ishte më shumë i pranishëm në program, aq më tepër kur ky ka qënë edhe rekomandim i eksperteve të vlerësimit e licensimit të programit.

Rekomandime

1. GVJ rekomandon që të punohet për të gjetur format e duhura për një promovim e marketing më efikas, përsa profili është risi e unik në tregun e punës.
2. GVJ rekomandon që strukturat drejtuese të UET të angazhohen më shumë për promovimin e programit, të përmbajtjes e objektivave të tij, pranë institucioneve shtetërore dhe private, fetare e të shoqërisë civile, duke argumentuar rëndësinë e nevojën e ekspertëve të fushës së "Studimit të Religjionit" e krijimit të kushteve për akses punësimi pranë tyre.
3. GVJ rekomandon që të realizohet një studim paraprak mbi qasjen e nevojave të tregut.
4. GVJ propozon që UET të bashkëpunojë me institucione që ofrojnë programe të përafërta me këtë master, brenda e jashtë vendit, për shkëmbim stafesh.
5. GVJ rekomandon që të ndërmerren projekte kërkimore/ forume/ konferenca shkencore, me fokus të veçantë në studimet e religjionit.
6. GVJ rekomandon që të rishikohen syllabuse të caktuara, për të krijuar më shumë hapësirë për adresimin më të mirë të problematikave që lidhen me kontekstin e aktualitetin shqiptar, brenda përmbajtjes të profilizimeve të programit

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Science / Arts in "Religious Studies" with profiles of the Institution of Higher Education "European University of Tirana"

Strengths and affirmations

1. The Master "Religious Studies", with the profiles "Comparison of Religions", "Security Issues", is a unique study program and innovation in the Albanian academic offer, which serves the preservation and promotion of national interests and values.
2. The European University of Tirana has a modern physical, didactic and logistical infrastructure that enables the successful realization of the teaching and scientific activity.
3. The University has a complete legal and regulatory framework, which enables the discipline of the teaching and research process - a very good practice of preserving documentation according to the standards and legal and sub-legal requirements in force.
4. The University has an efficient information system and uses digital platforms that help students, enabling access and information in real time.

Weaknesses

1. Insufficient promotion of the program for the interested public, given the importance and topicality of the master, in the context of the national and international development dynamics.
2. Insufficient interaction of university structures for the recognition of this program at state and religious institutions, public and private as well as civil society, interested in experts in the field of "Study of Religion".
3. Lack of a preliminary study on the market needs for this study program.
4. There is a lack of experts with a special research and scientific background in the field of studies and comparison of religions.
5. There is a lack of research projects / forums / scientific conferences with a special focus on the study of religion, which can interact with the study program.
6. From the review of the syllabi it is noticed that the Albanian context of the history, content and current issues of the inter-religious dialogue could have been more present in the program, especially when this was also the recommendation of the experts of evaluation and licensing of the program.

Recommendations

1. EEG recommends that work be done to find the right forms for a more efficient promotion and marketing, as the profile is a unique innovation in the labor market.
2. EEG recommends that the governing structures of UET be more engaged in the promotion of the program, its content and objectives, in state and private institutions, religious and civil society, arguing the importance and need of experts in the field of "Study of Religion" of creating conditions for employment access to them.
3. EEG recommends that a preliminary study be conducted on the approach to market needs.
4. EEG proposes that UET cooperate with institutions that offer programs similar to this master, inside and outside the country, for staff exchange.
5. EEG recommends that research projects / forums / scientific conferences be undertaken, with a special focus on the study of religion.
6. EEG recommends that certain syllabi be reviewed, in order to create more space for better addressing of issues related to the Albanian context and topicality, within the content of the program profiles.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X